

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 209, Mars 2021
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Letër e hapur drejtuar votuesve dhe kandidatëve! ²

Një nga emancipimet më të mëdha që ka shoqëria demokratike në tërësi është e drejta për të votuar. Kjo forcë që i është dhënë popullit të çdo shteti ka ndryshuar, është tjetërsuar gjatë periudhave të ndryshme kohore, e në këtë rrjedhe është edhe Shqipëria. Shqipëria dhe populli i saj i zgjedh vete drejtuesit e parlamentit dhe ata vendorë. Thuhet se çdo qeveri ka udhëheqësit që meriton dhe çfarë është e vërteta që Shqipëria nuk ka pasur udhëheqësit më të mirë dhe jo se i kemi merituar por le të themi se ashtu kanë ardhur rrethanat. E dimë se demokracia nuk është në ditët e saj më të mira duke u nisur edhe procesi i fundit zgjedhor në shtetin që supozohet te jete me demokratiku në botë, që është Amerika, në zgjedhjet e fundit, në fund të këtij procesi, le të shpresojmë apo të themi, se fitoi demokracia.

Dukagjin duaje dhe vlerësoje vetën

Në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 ka ardhur çasti më i mirë që Treva e Dukagjinit me dije dhe burrëri të votoj për të ardhmen e kësaj treve.

Duke u nisur nga paraqitja e kandidatave nga subjektet partiake mund të shprehemi se kanë filluar të bëjnë "ataktiken e vonuar dhe të domosdoshme" ndaj Trevës së Dukagjinit. Duke dashur të mos ndalemi në të shkuarën dhe të mendojmë për të ardhmen. Duke u ndalur tek kandidaturat e respektuara dhe me integritet, të cilat nuk u desh shumë të gjurmohet për prejardhjen Dukagjinase sepse këtë e kanë pranuar, kanë punuar dhe po premtojnë vetë kandidatët në fjalë. Ne si Shoqata Atdhetare Dukagjin në vazhdimësinë e misionit tonë për promovimin e vlerave dhe emancipimin, jemi të mendimit që nga votuesit e trevës së Dukagjinit kudo që të ndodhën të vlerësojnë dhe ta përdorin votën e besuar si të Shenjtë. Sipas bindjeve të tyre Politike votën krahas subjektit të tyre partiak të vlerësojnë edhe kandidatët nga Dukagjini pasi ato janë mundësi më e mirë që në Parlamentin Shqiptar zëri i Dukagjinit të dëgjohet bindshëm i pa kufizuar në kohë dhe territor. Ka ardhur koha të duam dhe vlerësojmë vetën me shumë se të tjerët. Ka shumë vite që besojmë, vlerësojmë dhe kontribuojmë për të tjerët. Koha e ka treguar se çfarë kemi mbjedhur atë kemi korrur. Me 25 Prill të drejtohem tek kutit e votimit me bindjen e thellë se kësaj radhe tek çdo subjekt politik kemi Dukagjinat të cilave do ju besojmë votën tonë dhe se bijtë e bijat Dukagjinase do jenë kambana e Dukagjinit në parlamentin Shqiptarë. Më poshtë po ju prezantojmë kandidaturat: Greta Bardeli Gjoni- PD, Jona Leqeja-PS, Emilja Koliqi-PD, Edmond Ndou-LSI, Arben Gjuraj-PD, Pal Shkambi- Kandidat i Pavarur...



Letër e hapur drejtuar votuesve dhe kandidatëve!

Një nga emancipimet më të mëdha që ka shoqëria demokratike në tërësi është e drejta për të votuar. Kjo forcë që i është dhënë popullit të çdo shteti ka ndryshuar, është tjetërsuar gjatë periudhave të ndryshme kohore, e në këtë rrjedhe është edhe Shqipëria. Shqipëria dhe populli i saj i zgjedh vete drejtuesit e parlamentit dhe ata vendorë. Thuhet se çdo qeveri ka udhëheqësit që meriton dhe çfarë është e vërteta që Shqipëria nuk ka pasur udhëheqësit më të mirë dhe jo se i kemi merituar por le të themi se ashtu kanë ardhur rrethanat. E dimë se demokracia nuk është në ditët e saj më të mira duke u nisur edhe procesi i fundit zgjedhor në shtetin që supozohet te jete me demokratiku në botë, që është Amerika, në zgjedhjet e fundit, në fund të këtij procesi, le të shpresojmë apo të themi, se fitoi demokracia.

Ky vit, është një vit zgjedhor në Shqipëri. Ky vit zgjedhor vjen pas një viti jo fort të thjeshtë, nga psikologjia, nga ekonomia, nga jeta sociale, se vimë nga një vit pandemik, i cili nuk ishte parë më parë. Jemi në një situatë që të rinjtë duan të ikën si nga vendi ku kanë lindur, nga qyteti apo fshati ku banojnë, në një



qytet me të madh dhe më të zhvilluar. Po ashtu duan të ikën edhe nga Shqipëria për një jete më të mirë. Dëshira ideale do të ishte që të rinjtë ti mbajmë në Shkodër, t'i mbajmë në Shqipëri. Pse të ikim, kur mund të kontribuojmë për vendin tonë, kur të gjitha të mirat i kemi dhe mund t'i bëjmë këtu.

Unë e di, se nuk është e lehtë askund, por mund t'ia dalim së bashku, sepse Shkodra i ka të gjitha.

Me bën më shumë besimplotë kjo, nga një thënie që dëgjoj në Kosovë sa here e vizitoj, kur ju them jam nga Shkodra, më thonë: - "A din se kur Zoti krijoi Shqiptarinë 2 oke gjysme (3. 75 kilograme) i la në Shkodër dhe gjysme oke(0. 750 kilogram) jua dha të tjerëve!"

Prandaj them se, ne vete mund ta kthejmë gjallërinë, plogështinë në diçka më të madhe, një qytet aktiv dhe jo vetëm, edhe Dukagjinin, që është perle e

Veriut të Shqipërisë, për nga intelijenca, ambienti, klima dhe mendjet e zgjuara që ka.

Duke u nisur nga titulli kërkesa që kam unë më këtë artikull, është për popullin të votojnë, ta thonë mendimin e tyre nëpërmjet votës, sepse ende nuk e dine se çfarë kanë në dorë, sesa të fuqishëm janë në procesin e vendimmarrjes, dhe për kandidatet t'u qëndrojnë afër personave që i kanë votuar, nevojat e tyre të jenë më vulnerabel, më të prekshme, pasi zhvillimi i një vendi vjen nëse populli i tij është i zhvilluar.

Do doja që për këtë çështje, e cila është thelbësore këtë vit, të thosha: Shqipërinë mund ta shpëtojnë vetëm Shqiptarët.

Të kërkojmë më shumë për veten, le të kërkojmë shërbimet që meritojmë në arsim, në shëndetësi, në shërbime administrate.

Të mos e shesim votën!

Të kërkojmë vetëm atë që meritojmë!

Të meritojmë dhe të punojmë më shumë për këtë, të mirën tonë të përbashkët të quajtur Shqipëri!

Klodjana Serraj

Dukagjin duaje dhe vlerësoje vetën

Në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 ka ardhur çasti më i mirë që Treva e Dukagjinit me dije dhe burrimi të votoj për të ardhmen e kësaj treve.

Duke u nisur nga paraqitja e kandidatave nga subjektet partiake mund të shprehemi se kanë filluar të bëjnë "atak-tiken e vonuar dhe të domosdoshme" ndaj Trevës së Dukagjinit. Duke dashur të mos ndalemi në të shkuarën dhe të mendojmë për të ardhmen. Duke u ndalur tek kandidatave e respektuara dhe me integritet, të cilat nuk u desh shumë të gjurmojmë për prejardhjen Dukagjinase sepse këtë e kanë pranuar, kanë punuar dhe po premtojnë vetë kandidatët në fjalë. Ne si Shoqata Atdhetare Dukagjin në vazhdimësinë e misionit tonë për promovimin e vlerave dhe emancipimin, jemi të mendimit që nga votuesit e trevës së Dukagjinit kudo që të ndodhën të vlerësojnë dhe ta përdorin votën e besuar si të Shenjtë. Sipas bindjeve të tyre Politike votën krahas subjektit të tyre partiak të vlerësojnë edhe kandidatët nga Dukagjini pasi ato janë mundësi më e mirë që në Parlamentin Shqiptar zëri i Dukagjinit të dëgjohet bindshëm i pa kufizuar në kohë dhe territor. Ka ardhur koha të duam dhe vlerësojmë vetën me shumë se të tjerët. Ka shumë vite që besojmë, vlerësojmë dhe kontribuojmë për të tjerët. Koha e ka treguar se çfarë kemi mbjedhur atë kemi korrur. Me 25 Prill të drejtohemi

tek kutit e votimit me bindjen e thellë se kësaj radhe tek çdo subjekt politik kemi Dukagjinin të cilave do ju besojmë votën tonë dhe se bijtë e bijat Dukagjinase do jenë kambana e Dukagjinit në parlamentin Shqiptar. Më poshtë po ju prezantojmë kandidatave:

- 1 Greta Bardeli Gjoni- PD
- 2 Jona Leqejza-PS
- 3 Emilja Koliqi-PD
- 4 Edmond Ndou-LSI
- 5 Arben Gjuraj-PD
- 6 Pal Shkambi- Kandidat I Pavarur

1 Greta Bardeli (Gjoni) - PD



Greta Bardeli (Gjoni), lindur në Shkodër, më 12 Prill 1980 është e martuar dhe ka 2 fëmijë.

Greta Bardeli rrjedh nga një familje e persekutuar nga regjimi komunist, familje me tradita e vlera të shquara, e njohur

për përpjekjet aktiviste në mbështetje të lëvizjeve demokratike në Shkodër; familje sportistësh, që ka trajnuar breza të tërë pjesë e ekipeve të Shkodrës si dhe Kombëtares së boksit.

- Doktor i Shkencave Juridike

- Pedagoge pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në Fakultetin e Drejtësisë si dhe pedagoge e ftuar pranë Universiteteve të ndryshme publike dhe jopublike në Tiranë.

- Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër.

- Drejtore dhe pjesëmarrëse në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e rajonit të Veriut dhe më gjere në kuadër të projekteve të BE për rajonet.

- Autore e disa artikujve shkencorë me karakter juridiko-ekonomik të publikuara pranë revistave prestigjioze shkencore dhe kërkimore, brenda dhe jashtë vendi, si dhe bashkautore e një vepre akademike.

Hapat e hedhur nga Greta në strukturat e PD- së kanë qenë gradual, bashkë me shkollimin, edukimin, rritjen e saj profesionale. Sot Greta është Doktore Shkencash në Drejtësi, është avokate dhe pedagoge. Çdo gjë e arritur vetëm falë punës, përkushtimit por edhe vendosmërisë për tu realizuar si grua. Zgjedhja erdhi natyrisht sepse Greta vinte nga një familje e persekutuar nga regjimi dhe shembulli

për tu ndjekur ishte ai i Zef Gjonit, babait të saj, ndër personazhet qendrore të zhvillimeve demokratike në Shkodër.

Greta Bardeli (Gjoni) është padyshim ndër "gratë e forta", të cilat fatmirësisht nuk i mungojnë Shkodrës. Gret ka qene dhe mbetet dera e hapur ku dukagjinisti morën mbështetjen dhe bashkpunimin. Ajo çfarë Greta ka demonstruar në këto vite, janë një sinjal i fortë se do të jetë një nga përfaqësueset më të denja të Shkodrës dhe Dukagjini në parlament.

2 Jona Leqejza - PS



Jona Leqejza ka lindur në Shkodër me 2 Tetor 1987.

Ka studiuar, për Master Shkencor Administrim Biznes, Vjenë Austri.

Master Shkencor Marketing, Vjenë Austri.

Kontabël i miratuar.

Kandidate për ACCA.
Ekspierenca në Punë
 Firma Audituese Ligjore Deloitte Albania 2009-2012.
 Firma Audituese Ligjore Ernst & Young 2012-2013.
 Madish Sh.p.k 2013 - në vazhdim.
 Menaxhere Marketingu.
 Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomisë, Dega Menaxhim 2011-2012
 Asistente Pedagoqe
 Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Fakulteti Ekonomisë Dega Menaxhim 2015-2016
 Asistente Pedagoqe.
 Qendra për zhvillim dhe neurorehabilitim “Ida Hoxha” 2019 - në vazhdim.
 Themeluese dhe drejtuese e OJFMargis Italia 2014-vazhdim.
 Anëtare e Këshillit Bashkiak Shkodër.
 Kandidon në radhët e PS e ëmbël në pamje, e zgjuar në mendime dhe forte në vendime.
 Kërkon dhe premtion “Barazi sociale”.
 “Barazia sociale” e Jonës është diçka e mrekullueshme që garanton për një të ardhme. Premton për ndryshime shumë të dëshiruara. Kërkon “barazia sociale” Jona e Gjergj Leqezjes e rritur mes te mirave të kësaj bote...të kërkoj “Barazi sociale”?! Nuk po e kërkon për vetë por për të gjithë. Kjo premtion shumë. Këtë “barazi sociale” ajo po e kërkon për shtresat në nevojë- të varfëritë, fëmijët jetim, gratë e dhunuara të moshuarit e harrur e të braktisurit, për të rinjtë e pa shpresë. Për Dukagjinin e lenë pas dore. Në damarët e saj rrjedh gjaku Dukagjinas nga kjo ajo merr forcë të jetë e vendosur në atë çka ndjen, mendon dhe kërkon.

3 Emilia Koliqi - PD



Emilia Koliqi, lindur në Shkodër, më 24 Shtator 1963 është e martuar dhe ka 5 fëmijë. Emilia Koliqi rrjedh nga një familje me vlera patriotike dhe kulturore të qytetit të Shkodrës.
 Babai i saj ka ushtruar profesionin e ekonomistit, të cilin e ka trashëguar edhe Emilia. Nëna, bijë e familjes së njohur shkodrane Suma ka dhënë kontribut në arsim dhe edukim. Origjina e nderuar është plotësuar me veprimin qytetar, me kontributin e saj personal në shoqëri, në administratë, në universitet dhe në politikë.
 - E diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, me titull “Ekonomist për financë”.
 - Eksperte kontabël dhe e financave publike, e trajnuar brenda dhe jashtë vendit, pranë institucioneve prestigjioze ndërkombëtare dhe publike.
 - Pedagoqe e jashtme në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
 - Njohëset më të mira në vend të çështjeve të administrimit financiar në përgjithësi dhe të qeverisjes vendore në veçanti.

Emilia Koliqi ka qenë pjesë e lëvizjeve demokratike e shoqërore. Si anëtare e Këshillit Bashkiak ajo ka përfaqësuar PD-në në mandatin 2007- 2011, është zgjedhur nënkryetare e Grup seksionit nr. 4 dhe është anëtare e Bordit të Këshilltarëve të PD- së Dega Shkodër, përgjegjëse për Qeverisjen Vendore dhe Administratën Publike.
 Pas vitit 1990, Emilia Koliqi i janë besuar pozicione të rëndësishme në administrimin financiar qendror dhe vendor:
 - Përgjegjëse e Degës së Thesarit Shkodër.
 - Drejtore e Drejtorisë së Aseteve në Bashkinë Shkodër.
 - Kryetare e degës së Financës pranë shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër.
 Anëtare e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë Tregu i shitjes me shumicë në Shkodër. Në punën e saj, Emilia ka treguar profesionalizëm, integritet moral, seriozitet, rigorozitet, korrektesë dhe përgjegjshmëri në punë, sidomos në menaxhimin e financave publike të qeverisjes vendore.
 Pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit 2015, ajo është Zëvendëskryetare e Bashkisë Shkodër.
 E kaluara dhe tashmja si nënë, bashkëshorte dhe profesioniste e aftë, premtion që Emilja do jetë një kthesë e mrekullueshme në Kuvendin Shqiptarë.

4 Edmond Ndou- LSI



Edmond Ndou lindi në qytetin e Shkodrës më 06.05.1990 në një familje të thjeshtë shkodrane nga dy prindër mjaft të vlerësuar e të respektuar nga ky qytet. Prindërit e tij Studimet e para akademike për drejtësi, dhe ato pas universitare “Master Shkencor” të profilizuar në Administratë Publike dhe Kushtetuese, Edmond Ndou i kreu në Shkodër. Më pas, duke mos u mjaftuar me aq në egot e tij për dije, gjatë viteve 2018 – 2019 kryen shkollën e specializuar të Avokaturës në Tiranë. Gjatë gjithë formimit të tij akademik Edmond Ndou përvetëson edhe disa gjuhë të huaja, të cilat janë një bonus kulturor për kornizën e tij, duke e përgatitur kështu edhe për një karrierë të suksesshme si lider politik apo juridik. Falë gjithë këtij përkushtimi, serioziteti në punë dhe respekti të ndërsjellët me njerëzit, që nga më të thjeshtit e deri tek personalitete të shquar të të gjitha dimensioneve, politike, juridike e diplomatike, Edmond Ndou në 2020-tën i akordohet titulli i lartë “Misionar dhe Ambasador i Paqes në Botë”. Ka qenë jurist në plotësimin e dokumenteve të pasurive të paluajtshme të Shkodrës, më vonë Edmond Ndou emërohet Drejtor i “Medja Nord”.
 Kjo përvojë e gjatë pune, dijesh, komunikimi dhe respekti të ndërsjellë me qytetarët e Qarkut të Shkodrës ka bërë që z. Edmond Ndou të guxojë sërish të

garojë në zgjedhjet e 25 prillit 2021 në strehën e tij të zemrës politike si deputet i LSI-së, i cili renditet i dyti në listën e këtij subjekti politik. Garimi i tij nga qytetarët e Qarkut të Shkodrës.
 Edmond Ndou vazhdimisht thotë: “Unë garoj për Shkodrën dhe qytetarët e saj dhe jo për poste individuale. Rinia duhet të marrë në dorë fatet e vendit. Shqipëria është e të gjithëve ndaj ne duhet të japim më të mirën tonë për këtë vend e në këtë vend!”
 Kjo është edhe arsyeja pse Edmond Ndou cilësohet si shkodrani me vizion të qartë për ardhmërinë e Shkodrës.

5 Arben Gjuraj - PD



Arben Gjuraj i lindur në fshatin Pentar të Dajçit të Bregut të Bunës dhe është banues në Shkodër, është i martuar dhe ka 4 fëmijë. Prej vitit 2015 mban postin e nënkryetarit të Bashkisë Shkodër dhe është pjesë e strukturave të PD, që në 1990.
 Në 2021 kandidon për deputet në Qarkun Shkodër.
 Arben Gjuraj, ka lindur më 28 Mars 1969 në Dajç rrjedh nga një familje e njohur me tradita patriotike. Përfshirja në zhvillimet demokratike në vend, kontributi qytetar dhe politik, angazhimi individual në shoqëri, janë vlerë e shtuar e trashëgimisë së tij familjare.
 Bashkëqytetar model, familjar i devotshëm, njeriu i komunikimit dhe argumentit, administratori i përkushtuar, bashkëbisedues i mrekullueshëm dhe këshillues i urtë, zyrtar profesionist, një derë e hapur për çdo kategori sociale dhe çdo individ, i gatshëm për të ofruar mbështetjen personale dhe ekspertizën profesionale kudo që i kërkohet, mik i mirë dhe fisnik.
 Karakterizohet nga modestia, vizioni, serioziteti, dëgjësia, përkushtimi për mbështetjen e qytetarëve dhe qëndrueshmëria në ndjekjen për përmbushjen e detyrimeve shoqërore dhe administrative.
 I diplomuar në Universitetin e Bujqësisë si Agronom i Përgjithshëm (1994) dhe më pas i diplomuar si Ekonomist i Politikave Agrare (2002).
 Z. Gjuraj ka një eksperiencë të gjatë në administrimin e problematikave që lidhen drejtpërdrejt me Qeverisjen Vendore dhe Zhvillimin Rural duke u shquar si një nga ekspertët më të mirë të kësaj fushe.
 I trajnuar mirë dhe i pajisur me njohuri të shumta në fushën e vlerësimit të rreziqeve në territor dhe planifikimin e menaxhimin e emergjencave civile. Karrierën në administratën publike e ka filluar si sekretar i Shkollës së Mesme në Dajç deri në vitin 2000, ku zgjidhet kryetar i Komunës Dajç për katër mandate radhazi. Pas reformës territoriale, ku ish-komuna Dajç i bashkëngjitet territorit

të Bashkisë Shkodër, zgjidhet si këshilltar i Bashkisë Shkodër, nga ku bëhet pjesë e kabinetit të kryetarit të Bashkisë Shkodër dhe më pas nënkryetar i kësaj Bashkie.
 Z. Gjuraj është pjesë e strukturave të Partisë Demokratike që në fillim të viteve 1990. Ai është zgjedhur në forumet drejtuese të PD-së Shkodër, duke iu besuar pozicioni i anëtarit të Kryesisë, sekretarit të Nëndegës. Arben Gjuraj është nënkryetar i Bashkisë Shkodër.
 Në zgjedhjet e vitit 2021 i është besuar të kandidoj për Parlamentin e Shqipërisë.

6- Pal Shkambi- I pavarur



Pal Shkambi ka lindur me 24 Gusht 1963 Shosh! Jeton në Shkodër, që nga viti 1979
 Në vitin 1998, Fakulteti i Drejtësisë në degën Juridik.
 Në vitin 2010, Fakultetit Ekonomik në degën Financë - Kontabilitet,
 Në vitin 2011 Fakulteti i Shkencave të Edukimit,
 Në vitin 2012-2014, Master Shkencor, Psikologji Klinike
 Nga muaji Maj 1998 – 2004, ka punuar pranë organeve të Policisë së shtetit si Oficer Policie, në sektorin e Rendit, Kriminal dhe të Informacionit.
 Në vitin 2002, ka titulluar në profesionin e Avokatit, me Nr. licence 1490, profesion që e ushtron mbi 15 vite pranë Dhomës së Avokatisë Shkodër.
 Në Qershor 2017- Janar 2021 zgjidhet anëtar i Vetingut nga ONM-ja dhe Votuar me 100 vota nga Kuvendi i Shqipërisë në Institucionin e KPK-së.
 Në Janar 2021 ka dhënë dorëheqje për të mundësuar aprovimi si Kandidat i Pavarur në Zgjedhjet për në Kuvendin e Shqipërisë.
 Sot Kandidat i Pavarur për Zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë.
 Kualifikimi: Kualifikuar Për Policinë Kriminale në “ICITAP” & “MAPO”.
 Në vitin 2015, diplomuar si “Njohës i politikave”, nga Akademia Profesionale Elita.
 Kam njohje në gjuhën angleze dhe në programin e kompjuterit.
 Meqenëse partitë politike diskriminuan dhe persekutuan Trevën e Dukagjinit për një çerek shekulli,
 duke e privuar nga përfaqësimi, lindi nevoja për një përfaqësim i respektuar si Kandidat i Pavarur për
 Deputet në Kuvendin e Shqipërisë.
 Pali thotë “Besoj se i ka ardhur koha që populli të zgjedh përfaqësues që marrin përsipër përgjegjësitë publike dhe shërbejnë në mënyrë të ndershme dhe të palodhur”.
 “Së bashku ia dalim”

Resurset natyrore, vlerat dhe traditat e Shllakut

Shllaku! Nga vjen ky emër? Fjala *shllaku*, vjen nga fjala *shlla*, ose *shullani* apo *shllasit*, vend që e kap dielli. Por, ka dhe mendime të tjera, që vjen nga fjala *llak*, që do të thotë *flokët e dëborës*, që bien e shkrihen.

Gjithsesi, pavarësisht nga e ka marre emrin, Shllaku të mahnit me bukurit natyrore që ka, por edhe me historinë që trashëgon ndër shekuj. Ka bjeshkën më të afërt me qytetin e Shkodrës si dhe vendin që e ka me shumë bimësi mjekësore, të cilat rriten në mënyra e vende të natyrshme, kryesisht në Cukal, në bjeshkën e Shllakut.


Kohët e fundit është një operator me origjinë nga Shllaku, që po merret kryesisht me promovimin e krahinës së Shllakut, kryesisht në rrjetet sociale, siç është facebook dhe youtube, por edhe në gazeta e televizione të ndryshme lokale, dhe në ato qendrore kombëtare.

Quhet Mark Gjeka, është me origjinë nga fshati Vukaj -Shllak, që në fakt nuk është lindur as nuk është rritur në Shllak, megjithatë gjyshi i tij, Pjeter Ndue Gjeka ishte nga Shllaku, fshati Vukaj. Dashuria nuk është e lidhur vetëm me njerëzit që na rrinë afër, por arrijt materiale, që njeriu ka bere në jete, dhe lidhet me koncepte më të mëdha, më frymëzuese, më shpresëdhënëse, siç është vendlindja.

Duke qene se kohet moderne sjellin edhe lëvizjet e vijueshme të njeriut, duket sikur vendi i të parëve në mendësitë e njerëzve është zbehur. Të paket janë ata, që i njohin mirë rrënjët e tyre.

Ka mbi 8 muaj që kameramani i njohur Mark Gjeka, në mënyrë vullnetare dhe krejtësisht falas po promovon vlerat historike dhe resurset natyrore të Shllakut. Marku nuk ka lindur në Shllak as nuk e kaluar fëmijërinë e hershme atje, mes bjeshkëve, por u rrit me historitë e gjyshit të tij, Pjeter Ndue Gjeka, i cili arriti të depërtonte në shpirtin e tij fëmijëror e të nguliste ndjenjat e dashurisë për tokën, dheun e të parëve. Burri i fisshëm e kishte kuptuar në sytë e Markut se, pikërisht ky, nipi i tij do i kthente sytë nga Shllaku, do i mësonte traditat dhe do të bënte diçka për atë krahinë të harruar.

**Korespondenti
i gazetës "Dukagjini"**



Pjeter Gjeka, me nipin Mark Gjeka



Pamje të përgjithshme të Shllakut



Foto Mark Gjeka



Foto Mark Gjeka

Lagja Çapaj, në fshatin Ukbibaj



Foto Mark Gjeka



Foto Mark Gjeka

Lagja Zbuq, në fshatin Vukaj

MIRASH NDOU: CIKLIN E KRESHNIKËVE E MORI NË VARR

(ÇFARË PORTRETI DHE KOSTUMOGRAFIE SHKËLQIMTARE)

Kam shkruar më parë diçka për më të ëmblin lahutarë, që kam dëgjuar me veshët e mi. Kam shkruar me dashuri, duke e ditë se edhe me shumë gjera që nuk i di te Mirashi, na i mori me vete.

Pal Malota, miku, dashmiri im, por dhe kushëriri më i afërt i sovranit lahutarë, më dërgoi dy audio të incizuar për një kanal të huaj, mos gabofsha francez, në mesin viteve 70-të. Incizimi nuk është bërë në studio, me magnetofon e as me teknikat e sotme, por gjithsesi është në parametra të lartë, ndonëse siç del na intervista, Mirashi kishte qenë i sëmure ato ditë.

AGA HYSEN AGA, titullohet njëra rapsodi. Fat që është ruajtur nga të huajt është 14 minuta ose diçka ma tepër deri në 18 minutave. E kam dëgjuar disa herë, por për herë e ma me endje e ma me mall. Rapsodia këndohet nga një zë i kulluar me thjeshtësi, lirshmëri, zhdërvjelltësi dhe butësi ledhatues- ledhatuese. Gjithsesi, lahutari nuk ndihej i kënaqur, ndonëse



intervistuesi i tha doli shumë mirë. Gjatë intervistës mësova se kishte qenë ftohë ato ditë, ku Mirashi i thotë më figuracion: “E keqja vjen shpejt e shkon ngadalë!” Në të folur lahutari kishte një zë të qartë, me timbër hollanik dhe lakonik në shprehje. Kam kënduar prej 50 vjet, kam prish e thye disa lahuta kur isha fëmijë, thoshte Mirashi. Lahutën e kishte mësuar rreth vatrës nga prindërit.

- Çfarë kënge do këndosh e pyet shqipëruesi ynë?

- Çfarë të duan gazetarja, -thotë Mi-

rashi

- Po çfarë di ti, ndërhyri përkthyesi:

- Unë këngët e kreshnikëve, këngë të buta dhe te sotëm i këndoi të gjitha. Sot kanë dalë të reja e nuk po kërkohen të vjetrat.

- Pyete çfarë do ajo se, unë di sa me ndejë një muaj nuk shperrem, por ajo nuk e ka gjithë këtë kohë!

Nga intervista del se përzgjedhjen e bëri Mirash, me një lirikë tjetër rapsodike, të cilën gëzohem që e ka Pali.

Pra, unë mësova përfundimisht se, Mirash Ndou dinte të këndonte gjithë ciklin e kreshnikëve! E pati intervistua Benardin Palaj kur i shkroi nga odat e rapsodëve. Ndërkohë injorantët në institucionet e radio televizorit, kërkonin që lahuta ti këndonte partisë dhe kënga të mos e zgjaste më shumë se 3 minuta. Në aq sa militare injorantë, jemi racist dhe diskriminues. Në qytetet tona për hir të ashtu quajtur modernizëm primitiv të qeshnin, po këndonte dikush

me lahutë dhe çifteli, ndërkohë që Radio Titogradi kishte emision javore 30 minuta me cikël rapsodish me lahutë. Hipokrit të shpifur sot shtireni si nacionalist me pallë gomari dhe pëllisni duke thënë: “Na mori Serbi lahutën!” Jo, ne u vramë këngën në buzë lahutarëve. Për një bobinë shiritash dhe paragjykimesh idiote na iku Mirashi e sa e sa Mirasha të tjerë. Më vlerë sa e gjithë godina e Radio Shkodrës dhe gjithë pallatet, që i kanë kërcyer në shpinë, do ishte incizimi i plotë i gjithë ciklit i kreshnikëve.

Nga kjo interviste përforcova mendimin se, ai këngëtare që nuk zotëron shumicën e ciklit të kreshnikëve, nuk është lahutarë. Ende kemi vokale të shkëlqyera, por në moshë të thyer nuk mund përvetësohet, ashta poetike rapsodive kreshnike. Poezia e ciklit të kreshnikëve, është baza dhe ajka e metrikes sonë poetike, që as një kultivues modern i poetikës nuk është aq origjinal dhe aq i dëlire. Nga Epika historike kreshnike, Fishta siti “Lahutën e Malësisë”, e cila sa do madhështore që është mbetet e bija, që nuk kapi fronin e nënës.

Jemi rritur me këngët qytetare shkodrane, tiranase, elbasanase, gjakovare, ulqinake e të tjera. Ato shkëlqejnë në planin muzikal, por nuk kanë kurrfarë poezie në raport me epiken kreshnike ndërkohë nga që janë të mbushura plot me fjalë të huaja.

Mirash Ndou iku dhe këngët kreshnike i mori me vete. Ëndërrën më të madhe të lahutarit ja vramë!

I vramë këngët, që është po aq kriminale se vrasja e kundërshtarëve.

Prele Milani

Përse truri përqendrohet tek negativja?

Thuhet se njeriu është zot i mendimeve të veta. Të paktën shumica kështu mendojnë.

Është mendim i gabuar, thonë psikologët. Sipas psikologjisë, truri i njeriut, vendosë për pjesën më të madhe të mendimeve dhe veprimeve të njeriut.

Në këtë çështje, problemi madhor është se, tek shumica e njerëzve, truri priret drejt mendimeve negative. Kjo është tendenca e trurit “katastrofal”.

Këtu ka dhe një gjë të mirë, ti nuk je i detyruar të ndjekësh rrugën e trurit. Nëpërmjet mekanizmit të ndjenjave, mund ta manipulosh atë.

Të mbijetuarit është qëllimi kryesor i trurit. Sot, ky qëllim, duket sikur ka kaluar diku, në fshehtësi të trurit, nuk është aq aktiv sa dikur. Jetojmë në një vend të lirë, demokratik, relativisht të sigurt.

Kështu mendojmë ne, por jo dhe truri ynë. Në trurin tonë, vazhdon si më parë „programi“ i para mijëra viteve. Programi kur njeriu, përballej me shumë rreziqe, të ditës dhe natës. Ai përqendrohet në rreziqet e mundshme.

Interesant është fakti që, truri, i ruan për një kohë shumë të gjatë, skenat e rreziqut, edhe nëse ato nuk shfaqen kurrë. Kjo do të thotë që, proceset që zhvillohen në trurin tonë, truri nuk i diferencon ato reale, nga ato të menduara.

Disa situata nga të cilat njeriu ka frikë,

zgjojnë tek ai ndjenjat negative. Shpesh ato qëndrojnë për një kohë të gjatë, derisa njeriu bindet se, nuk përbëjnë rrezik ose, kaloi rreziku.

E keni përjetuar një gjë të tillë? Nëse po, pa merak! Nuk jeni i vetmi.

Është e vështirë të shijosh të mirën, dhe të përqendrosh tek pozitivja. Truri “katastrofal” vazhdimisht përqendrohet në modelin e mendimeve negative. Të mirat i mjegullon. Nëse e njihni këtë “marifet” të trurit, nuk duhet të shqetësoheni, fare. Nuk ta dëmton aspak kualitetin e jetës. Nëse truri të provokon me skena të së kaluarës, dhe ti je i bindur se ato nuk janë më pjesë e jetës tënde, vetëm injorohi. Truri është “mashtues” i keq. Ashtu si çdo mashtues tjetër, duhet të mësosh ta mashtosh edhe ti, trurin tënd. Një gjë e tillë mund të mësohet, madje shumë mirë.

Për këtë, ka rëndësi të mësuarit e principeve bazë.

Nëse ti, pret diçka negative, për shkak të trurit tënd “katastrofal”, ka shumë mundësi që do biesh në “kurthin” e trurit dhe, ta përjetosh atë që pret.

Nëse truri yt, e ka projektuar bashkëshortin apo kolegun tënd si njeri negativ, ashtu do të reagosh ndaj tij. Do të përqendrosh vetëm në anët negative të tij, dhe do ta mendosh njeri negativ.

Frika e dështimit, është shumë e njohur. Nëse truri yt, të përsëritë vazhdi-

misht se je i dështuar, dhe ti e dëgjon atë, sigurisht që do të dështosh. E garantuar kjo. Thjesht truri, nga natyra e vet, është programuar për të “ndjell” të keqen dhe errësuar pozitiven.

Shtrohet pyetja: Ka shpëtim nga ky tru “mashtues”?

Po, përgjigjja është pozitive.

Këshillat e mëposhtme, të ndihmojnë për të ndërtuar “mekanizmin” e mbrojtjes kundër trurit “mashtues”. Por, duhet pak vullnet.

1. Hape një ditar dhe çdo ditë, shëno gjërat e mira të ditës. Gjithçka të mirë që ke përjetuar, në familje, punë, shoqëri dhe kudo. Në mënyrë të vetëdijshme, injorohi dhe bllokoji të këqijat. Zhduki, nga mendja dhe ditari. Kështu ti e trajnon trurin tënd që të përqendrohet në gjërat e mira, në pozitiven. Edhe për vogëlsirat.

2. Mundohu që, në mënyrë të vetëdijshme, t’i harrosh ndodhitë negative të ditës, dhe të përqendrosh vetëm në pozitivet. Sidomos në rastet kur ndjen frikë, kur e veni re se, humori yt është i keq dhe ndjehesh i nervozuar.

3. Përqendrohu në “këtu” dhe “tani”. Harroje të djeshmen, dhe lere të nesërmen!

Rikthimi tek e djeshmja, zgjon shumë ndjenja negative, të cilat mund të jenë në gjendje dremitje. Frika dhe emocionet e tjera negative, nga mundësia e përsëritjes

së gjërave, edhe nëse ato nuk ndodhin kurrë, janë shumë të dëmshme. Truri nuk heq dorë nga ato. Këtë duhet ta bësh ti, duke menduar dhe përqendruar në të sotmen. Ktheje “timonin” e mendimeve, përsëri, dhe përsëri. Anija merr kursin që i jep timonieri dhe jo era.

4. Gërmo në sirtarët e tua dhe zgjidh fotot, vidiot dhe korrespondencat më të këndshme, nga aktivitetet dhe kontaktet me botën dhe të tjerë. Përqendrohu tek momentet më të këndshme që ke përjetuar.

Teorikisht, ti nuk ke pushtet mbi mendimet e tua, por mund ta kërkosh dhe fitosh. Një gjë e tillë, nuk është aq e vështirë, dhe kursesi e pamundur. Duhet durim dhe ushtrime. Të ushtruarit e bën njeriun mjeshtër.

Nga të përsëriturit e kësaj strategjie, mendimi pozitiv, do të bëhet një gjë rutinë, për trurin tënd.

Gradualisht, krijohen lidhje të reja të sinapseve, dhe të vjetrat kalojnë në gjendje dremitje. Bashkë me ato, edhe mendimet e tua katastrofale.

Durim dhe guxim dhe, shumë shpejt do të ndjehesh optimist, i qetë dhe i sigurt, në jetë dhe punë.

Lekë Imeraj-shkrimtar,
përkthyes, publicist

KOMPOZITORI ZEF ÇOBA DHE KONTRIBUTI I TIJ NË MUZIKËN SHQIPTARE

Dekorohet me titullin “Mjeshtër i Madh” Zef Çoba, kompozitori i këngës së famshme “N’xhamadanin vija-vija”

Shkodra është një qytet i madh, i bukur e plot jetë, me rëndësi të madhe historike dhe bashkëkohore. Ajo është një qendër e rëndësishme akademike, shkencore, kulturore dhe sportive. Dhe jo më kot shpesh quhet edhe “Metropoli i Veriut”. Natyra e mrekullueshme, trashëgimia kulturore dhe historike, zhvillimi i sistemit urban, pedonalet, lulishtet dhe shatërvanët, vajzat dhe djemtë e bukur e të shkathët, njerëzit e qeshur dhe gazmorë, e bëjnë këtë qytet të dashur dhe të këndshëm për këdo.

Arti dhe kultura janë ato që Shkodrën nuk e lënë të plaket kurrë, sepse ajo është djep kulture e dije, e cila, si një nënë e mirë vazhdon të përkundë edhe sot e kësaj dite këtë djep që rrit filiza të talentuar në të gjitha fushat. Tashmë muzika shkodrane e përkundur në këtë djep njihet mirë, pëlqehet nga çdokush dhe është pjesë e arritjeve të muzikës shqiptare.

Këngët e bukura shkodrane epike dhe lirike dhe në veçanti jaret e famshme, ka kohë që kanë kaluar kufijtë e Shkodrës dhe janë bërë të njohura duke u interpretuar dhe studiuar në Shqipëri dhe në Botë.

Të shkruash për një personalitet të artit dhe krijimtarisë muzikore shqiptare, siç është profesor Zef Çoba, i cili para pak ditësh u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh” është një nder i madh edhe për mua si gazetar që prej disa vitesh përpiqem të jap kontributin tim për arritjet kulturore e artistike të qytetit të Shkodrës.

Personalitetet e artit dhe muzikës, krijuesit e mëdhenj, e thënë me plot gojë, janë një kala tjetër për këtë qytet. Në themelet e kësaj kalaje kanë vënë gurë të çmuar mjeshtër: Prenk Jakova, Pjetër Gaci, Çesk Zadeja, Tish Daija, Tonin Harapi, etj. Në këtë rrugë do të ecte edhe kompozitori i mirënjohur Zef Çoba, i cili biografisë e karrierës së tij artistike e ka shkruar mbështetur në mësimet e këtyre kollosëve të pavdekshëm dhe në bekimin e Shkodër Loces.

Komisioni i vlerësimit të figurave në fushën a artit pranë Ministrisë së Arsimit e vlerësoi Zef Çoben me titullin “Profesor” duke e emëruar si rektor në Akademinë e Arteve në Shkodër.

Ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e muzikës shqiptare, me formë e përmbajtje kombëtare dhe bashkëkohore njëherazi, si krijues, por edhe si pedagog dhe drejtues ai ka gjithashtu një kontribut të madh në ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve të kësaj fushe. Momenti i akordimit të titullit “Profesor” e shpërbleu më së miri këtë kontribut.

Zef Çoba ka lindur në Shkodër më 17 korrik 1951, në një familje të vjetër qytetare. Pasioni i tij për muzikën ka filluar që në moshë të re.

Ka mbaruar Institutin e Lartë të Arteve

në vitin 1974, në degën e dirigjimit koral. Ka filluar punën në Peshkopi si përgjegjës muzike pranë Shtëpisë së Kulturës të këtij qyteti. Këtu përveç hulumtimit të pasurive folklorike të kësaj treve fillon të vihet në jetë pasioni i tij për kompozicionin, frytet e të cilit nuk vonojnë. Pas një qëndrimi shtatëvjeçar në qytetin e Peshkopisë në vitin 1980 largohet duke lënë gjurmë me punën e tij të palodhur e pasionante. Thonë se dhe sot e kësaj dite një shkollë në Peshkopi e quajnë Shkolla e Zef Çobës.

Pas transferimit me të njëjtën detyrë

Zefi është një njohës i mirë i muzikës së mrekullueshme botërore dhe asaj shqiptare.

Në një bisedë me shefin e muzikës të Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, z.Bardhyl Hysa mësuam se: “Në qytetin e Shkodrës Zef Çoba është figura më e respektuar që përfaqëson plejadën e muzikantëve që i kanë dhënë emër këtij qyteti. Duke qenë pjesë e artit muzikor e ndjej veten krenar dhe shumë të lumtur që në qytetin tonë vazhdon të kontribuojë me emrin dhe punën e tij, si figurë shumë dimensionale, artisti i kompletuar prof.

shëm dhe tepër i veçantë në komunikim me këngëtarët, veçanërisht me mua si Bujar, kur diskutohet për këngën popullore qytetare, si dhe një muzikant e kompozitor me vlera shumë të mëdha artistike, i cili ka lënë gjurmë në muzikën shqiptare, prandaj meriton respektin dhe falenderimet e mia si artist”.

Prof. Valton Beqiri, kompozitor, pedagog në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ish Ministër i Kulturës në Kosovë shpreh për Zef Çobën: “Vlerësimi i personaliteteve nga fusha e artit dhe kulturës,



emërohet në Shtëpinë e Kulturës së qytetit të lindjes. Gjatë kësaj periudhe janë edhe kompozimet e tij për festivalet e fëmijëve që zhvilloheshin në qytetin e Shkodrës. Prej vitit 1991 do të punojë pranë Radio “Shkodrës” si specialist i programeve muzikore. Që nga viti 1997 është drejtues artistik i korit “Schola Cantorum Dom Mikel Koliqi” të Shkodrës.

Vitet në vazhdim do të flasin për një kompozitor të kompletuar, gjë që bëri që në fushën kinematografike të kompozojë muzikën e më se 15 filmave. Ai mori edhe disa çmime në Festivalin e Filmit Shqiptar. Kështu mund të përmendim Medaljonin e Festivalit për muzikën e filmit “Skëterrë ‘43”, në Festivalin e IV të Filmit Shqiptar, si dhe Medaljonin e Festivalit për muzikën e filmit “Muri i gjallë”, në Festivalin VIII të Filmit Shqiptar të vitit 1989 dhe së fundi kompozimi i muzikës së filmit “Dashuria e fundit” në vitin 1994.

Zefi. Gjithashtu mendoj se vepra shumëplanshe dhe aktiviteti i tij artistik që vazhdon me intensitet, tejkalojnë çdo koment dhe fjalë që mund të thuhet për Zef Çobën. Është një fakt i pa mohueshëm që mbas emrave të mëdhenj që Shkodra ka nxjerrë në fushën e muzikës, Zefi është vazhduesi i vlerave dhe i garancisë së kësaj trashëgimie”.

Profesor Fadil Kraja, dramaturg i mirënjohur, thotë për prof. Zef Çoben se: “Është muzikolog i kompletuar i shumë dimensioneve, kompozitor i nderuar në shkallë mbarëkombëtare, lëvruesi i të gjitha zhanreve muzikore, dirigjent me peshë, pedagog shumë i përgatitur, erudit. Ai thotë me bindje se pa emrin e Zef Çobës, muzika shqiptare dhe historia e saj do të ishte më e varfër”.

Ja si shprehet një nga artistët më të shquar shkodran, “Mjeshtri i Madh”, këngëtar Bujar Qamili për Prof. Zef Çobën: “Një personalitet i jashtëzakon-

shpesh herë bëhet me vonesë ose post mortum! Është më se e nevojshme që ata të nderohen në kohën kur kanë ende mundësi të krijojnë dhe të japin kontributin e tyre në jetën kulturore. Vlerësimi i dirigjentit dhe kompozitorit Zef Çoba, nderon Shkodrën por edhe gjithë shqiptarët. Krijimtaria e tij muzikore u takon të gjithëve për çka i jemi mirënjohës. Duke i uruar shëndet dhe punë të vazhdueshme krijuese, dëshiroj që vlerësimet dhe sukseset t’i shtohen porsivijat e xhamadanit të tij krijues”.

Këngëtarja Shkurte Fejza “Mjeshtre e Madhe” me shumë dashamirësi vlerëson punën e palodhur të këtij kompozitori të madh, por edhe kujton kohën e bashkëpunimit me të: “Jam e lumtur dhe ia uroj nga zemra titullin “Mjeshtër i Madh” kompozitorit Zef Çoba. Me Zefin bashkëpunuam në rrethana të vështira, kur unë erdha për herë të parë në Shqipëri, në Shkodër dhe këtë ëndërr e këtë udhë-

tim të parë e konkretizuar duke realizuar këngën tanimë himn i të gjithë shqiptarëve “N’xhamadanin vija-vija, është Kosova është Shqipëria” për të realizuar edhe këngë të tjera bashkë gjatë asaj periudhe.

Opusit të gjërë të krijimtarisë muzikore të Zef Çobës edhe kjo këngë ia shton madhështinë dhe unë ndjem krenare dhe e mirëpres me shumë respekt e mirënjohje. Zefit i uroj shëndet, sepse sukseset nuk i mungojnë. Uroj dhe shpresoj se edhe në të ardhmen do të bashkëpunojmë, sepse vetëm Mjeshtret e Mëdhenjë krijojnë vepra të mëdha.

Urime Zef Çoba. Urime Shkodrës, djepit të kulturës shqiptare”.

Një tjetër personalitet i shquar në Kosovë, Prof. Dr. Behar Arllati - Etnomuzikolog në opinionin e tij për Zef Çobën shprehet: “Në mozaikun e figurave muzikore të Shkodrës ka dhjetëra e qindra “gurë” të mëdhenj e të vegjël që e formojnë gjithë atë tërësi të madhe të muzikës shqiptare. Një nga këta gurë të

të dukshëm e madje, pse jo, dhe në mesin e kompozitorëve që bëjnë pjesë në Panteonin e muzikës së kultivuar shkodrane e mbarëshqiptare.

Çmimi i dhënë atij, megjithëse i vonshëm, është vetëm një shtysë dhe një kurajo më shumë që Mjeshtri Zef Çoba të vazhdojë si deri më tani, të krijojë vepra madhore dhe të pavdekshme».

Në festivalin e parë të Këngës Popullore Qytetare Shqiptare organizuar në Tiranë në vitin 2012, nga RTSH me krijime të reja nga 10 këngëtarët më të mirë të Shqipërisë, duke përfshirë këtu edhe këngëtarin nga Kosova Shkëlzen Jetishin dhe këngëtarin nga Maqedonia Selami Kolonja, profesor Zefi u përfaqësua me një kompozim të përkryer, me tekst të poetit Alfred Çapaliku, titulluar “E bukur si hanë” kënduar nga “Mjeshtri i Madh” Bujar Qamili, këngë e cila u ekzekutua nga orkestra famoze e RTSH, ku pati një sukses të jashtëzakonshëm, duke u mirëpritur me duartrokitje gjatë gjithë kohës nga publiku që kishte tejmbushur

ekzistonte në Shqipëri) në muajt tetor, nëntor, dhjetor 1992.

Në mbrëmjen e datës 17 tetor nuk këndoi, por premtoj se në javën e ardhshme do të këndonte një këngë. Të nesërmen, në mbrëmjen e datës 18.10.1992 erdhi në shtëpinë time me bashkëshortin e saj Hajrush Beluli, e me kërkoi që t’i kompozoi këngën që kishte premtuar se do të këndonte”.

Ndër të tjera ai shton: “Krijimtarinë time e kam të lidhur shumë me ndërjegjen tonë kombëtare. Kam studiuar shumë etnosin dhe folklorin tonë muzikor dhe kur krijova këtë këngë isha me një “ngarkesë” të tillë kombëtare. Rashë dakord për këngën me këngëtarin Shkurte Fejza dhe shkova menjëherë tek miku im poet Alfred Capaliku. Ishin orët e vona të natës dhe i thashë të zgjohej nga gjumi dhe të fillonim menjëherë punën. Atë natë kemi punuar deri në orën 4 të mëngjesit dhe në orën 5 gjithçka ishte e mbaruar”.

Kompozitori Zef Çoba kujton: “Kam marrë shumë çmime, por ajo që më kre-

kjo këngë të fitojë popullaritet dhe u bë si Himn Kombëtar i dytë për gjithë shqiptarinë. Për 18 vite autorët e saj nuk ishin përmendur, pasi ajo ishte kthyer në një këngë mbarë popullore.

Zef Çoba ka kompozuar vepra dhe pjesë të ndryshme vokale e instrumentale, këngë në stil të traditës së këngës qytetare shkodrane, shumë prej të cilave kanë fituar popullaritet të gjërë, këngë për fëmijë etj. Ka kompozuar një cikël me romanca vokale të titulluar “Kënga e njeriut”. Ciklin me këngë korale për fëmijë “E drejta dhe e shtrembra”, shumë përpunime këngësh popullore për kor, për solistë etj.

Në vitin 1999 ka themeluar në Shkodër Shoqatën Miqtë e Muzikës “Rozafa Expression”. Shoqata zhvillon me sukses një aktivitet artistik e kulturor, kombëtar e ndërkombëtar.

“Është e vërtetë, unë jam shkodoran dhe e dua shumë Shkodrën, shprehet kompozitori i shquar në një intervistë televizive, por interesat e mia si studiues janë shumë më të gjëra, janë me një vizion kombëtar, bile-bile edhe universal, sepse muzika është një art universal”.

Prof. Zefi është karakterizuar në drejtim nga një punë me disiplinë e kërkesa të larta artistike dhe për këtë në turnetë e zhvilluara si brenda dhe jashtë vendit, është vlerësuar me konsiderata të larta. Si kompozitor dhe dirigjent është nderuar dhe vlerësuar me çmime të ndryshme. Ky krijues, por edhe studiues i trashëgimisë muzikore folklorike dhe të kultivuar e lidh punën e tij, që me plot gojën mund të themi se është një përpjekje titanike, me të gjitha trevat jo vetëm në territorin e Republikës, por që nga Jugu në Veri në të gjithë hapsirën shqipfolëse.

“Kudo në çdo trevë të Shqipërisë, shprehet ai, ta dini se aty jam unë”.

Zef Çoba është nderuar me shumë tituj nderi ku mund të përmendim Urdhërin “Naim Frashëri” i Klasit III - Urdhër i dhënë nga Presidenti i Kuvendit Popullor në vitin 1989, “Nderi i Kulturës Dibrane”, vlerësuar nga Këshilli Bashkiak i Peshkopisë, “Anëtar nderi” i Shoqatës Kulturore Artistike “Besa” në Mal të Zi, “Anëtar nderi” i Shoqatës “Madonna di San Giovanni” Ripatransone-Itali, etj. për të ardhur në vlerësimin e lartë “Mjeshtër i Madh” akorduar para pak ditësh nga Presidenti i Republikës.

Jeta dhe karriera e tij artistike nuk janë thjesht një CV që mund të krenojë çdo artist të këtij niveli, përkundrazi ato janë një kronologji e pasur në vite dhe bashkëkohore që bëjnë krenar jo vetëm artistin, por edhe qytetin e tij edhe kombin e tij.

Prof. Zef Çoba tanimë është në pension, por pavarësisht nga kjo ai vazhdon bashkëpunimet shkencore, vazhdon jetën akademike artistike, është shumë aktiv në profesionin e tij, në krijimtarinë e tij dhe në bashkëpunimin e madh që mban gjithmonë në marrëdhëniet me kolegët, me krijuesit, me studentët e veçanërisht me të rinjtë e apasionuar pas muzikës.

Ashtu si të gjithë kolegët, miqtë, bashkëqytetarë dhe gjithë bashkëkombasit edhe unë i uroj përmes këtij shkrimi Prof. Zef Çobës ta gëzojë titullin e lartë dhe mjeshtërinë e tij ta verë gjithmonë në shërbim të kulturës kombëtare.

Ramazan Çeka, Shkurt 2021



mëdhenj është edhe Prof. Dr. Behar Arllati, kompozitori, pedagogu e dirigjenti Zef Çoba. Krijimtaria e tërësishme e profesor Çobës dallohet për vepra të mëdha, monumentale pavarësisht se bëhet fjalë për një vepër korale, instrumentale apo edhe këngë të thjeshtë. Që të gjitha janë monumentale ashtu siç janë të mëdha dhe punët në aspektin pedagogjik apo dhe si dirigjent i Korit “Rozafa Expression”.

Në fakt, nuk është aspak e lehtë që “t’ia qëllosh” gjithmonë në muzikë, nuk është e lehtë aspak që të kompozosh vetëm vepra që mbeten në kujtesë, vepra monumentale që “zhburojnë dhe gjejnë vend” në memorien e popullit. Këtë, me shumë lehtësi, ka arritë ta bëjë profesori e kompozitori Zef Çoba falë invencionit të tij të madh krijues.

Rrjedhimisht, duhet patjetër të thuhet se në historinë muzikore të qytetit të Shkodrës, por dhe atë shqiptare, kompozitori Zef Çoba zë një vend meritator, shumë

sallën e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë.

18 vjet më parë, brenda pak orëve, brenda një nate, kompozitori Zef Çoba dhe miku i tij, poeti Alfred Çapaliku krijuan këngën aq shumë të njohur “N’xhamadanin vija-vija”. Tashmë kjo këngë këndohet e dëgjohet gjithandej nga shqiptarët e të gjitha moshave dhe është kthyer në një këngë mit, një këngë që frymëzon dhe lidh brezat. Autorët e kësaj kënge edhe sot e kësaj dite tregojnë me pasion e krenari për historinë e lindjes së saj në vitin 1992 në qytetin e Shkodrës dhe që u këndua për herë të parë nga këngëtarja e mirënjohur kosovare Shkurte Fejza.

“Kënga “KAM NJË LOT M’PIKON SI AR” u kompozua me porosi të këngëtares Shkurte Fejza. Ajo ishte e ftuar në javën e tretë më datë 17.10.1992 në spektaklin “12 vallëzime pa një të shtunë” të regjisores Vera Grabocka, që u zhvillua në TVSH (i vetmi stacion televiziv që

non më shumë është kur më 2 shtator të vitit 2002, në ndeshjen miqësore Kosovë-Shqipëri i gjithë stadiumi buçiste duke kënduar refrenin e kësaj kënge”. Ky është çmimi më i madh për Zef Çobën.

Poeti Alfred Çapaliku, autori i tekstit të këngës “N’xhamadanin vija-vija”, thekson: “Në darkë vonë më erdhën në shtëpi Shkurte Fejza me bashkëshortin dhe miku im Zef Çoba. I thashë gruas t’i shërbente mysafirëve dhe vetë u futa në dhomën time për të shkruar i qetë tekstin e këngës. Mora frymëzim nga Shkurte Fejza dhe e nisa tekstin si një udhëtim, udhëtimin që kishte bërë këngëtarja nga Kosova për të ardhur në Shqipëri.

Më vjen mirë që kjo këngë po e humb autorësinë dhe është bërë kaq popullore. Kështu ndodh me krijimtarinë e arritur në nivele të larta. E humb autorësinë dhe bëhet pronë e popullit. Kjo natyrisht të bën të ndjehesh shumë krenar.”

Forca sugjestionuese artistike bëri që

"Një adoleshent në familje"



Të dashur lexues-prindër, a nuk janë fëmijët tuaj një nga këto dhurata që Zoti jua dhuron ju dhe u porosit që tu shërbeni me dashuri. Rastis që një fëmijë të vijë në jetën tuaj pa dëshirën tuaj. Po kjo nuk do të thotë që ju tani të bëni çfarë të doni me të, jo këtë mos e thëntë Zoti që të ndodhë, e kuptojmë se sipas planifikimit tuaj kjo dhuratë është e parakohshme, jo, ju nuk keni të drejtë që të mendoni kështu. Ky fëmijë që u bëhet dhuratë në këtë kohë, Zoti e di mirë përse ky duhet të vijë në mesin tuaj tani. Ai ka planet për familjen tuaj. Asnjë planifikim i juaji nuk është më i përsosur se plani i Zotit për të dhe për ju. Prandaj ju lutem me përvujtëri dhe falënderim pranoheni dhe përgatituni për ardhjen e tij në mesin tuaj. Fëmija rritet, ai tani është 12-13 vjeç që ka hyrë në hapat e para të adoleshencës. Siç mund t'i themi ndryshe- për djalin që po rritet e po fillon të bëhet i zoti i vetes. Dhe që fillon ti befasojë të rriturit sidomos prindërit me disa ndryshime në sjellje, në të folur, në edukatë, në komunikim. Aq sa ata edhe mund të habiten me këto ndryshime dhe pyesin: Nga erdhën? Si erdhën? Ç' duhet bërë?

Prindërve fillon e u bie në sy një farë vrazhdësie në të folurit e djalit. Një notë e re që nuk e kanë kapur më parë. Ata mund të mos e dinë që edhe vetë zëri ka ndryshuar organikisht, është bërë më i trashë. Por nuk është çështja thjesht tek zëri. Bie në sy më shumë njëfarë vrazhdësie në ton e në fjalor. Djali duket sikur nuk i ka qejf më pyetjet e shumta e të shpeshta, për gjëra të rëndomta, sidomos për çështje personale të tija. Edhe përgjigjet e tij janë më të shkurtra e më të prera. Madje qëllon që edhe nuk i përgjigjet fare ndonjë pyetjeje. Vetëm të shikon: Ose mund të mos shikojë fare. Prindërit kjo sjellje e djalit fillon e i ngacmon madje edhe i zemëron.

Ata janë mësuar që djali të jetë më i afërt, më i hapur, më i komunikueshëm, më i dëgjueshëm. Por shqetësimi vjen duke u rritur. Djali kthehet në shtëpi nga shkolla, nga loja ose nga një punë tjetër. Prindërve u duket se nuk i përshëndet më për së

mbari. Sikur thotë mezi një mirëdita. Ose thotë "nëpër dhëmbë". Sikur po hungëron diçka. Madje mund të mos përshëndesë fare. Prindi mund të fillojë të habitet: «Çfarë po ndodh me djalin?! Ai ka qenë i sjellshëm». Tani ka filluar të mos pranojë ndërhyrjet në punët e tija. Ta zëmë, më parë ai ka zbatuar njëfarë regjimi. Në këtë kanë ndikuar pozitivisht edhe prindërit. Kur ka pasur shkelje të rënda regjimi, ata e kanë qortuar atë. Madje, ndoshta edhe për shkelje të lehta, megjithëse jo gjithmonë pa kundërshtime, ai mund t'i ketë



pranuar këto qortime, kurse tani ka filluar të ndryshojë puna.

Ti i bën vërejtje për ndonjë shkelje regjimi, për ndonjë vonesë, për ndonjë shikim të tepruar të programit televiziv në kurriz të përgatitjes së mësimeve, për ndonjë kthim në shtëpi mbrëmjeve më vonë se duhet, për ndonjë dalje pak të zgjatur nga shtëpia, jo vetëm pa marrë leje, por pa vënë në dijeni. Mirëpo djali pa të keq mund të thotë e di vetë. Ose mund të mos përgjigjet fare, mund t'i shmanget diskutimit qoftë edhe një bisede të shkurtër. Përsëri prindi mund të befasohet. A e sheh se te djali po zhvillohet njëfarë shpirti kundërshtimi. E gjen këtë në shikim, në të folur, në komunikim, në veprime. Ndonjëherë ky shpirt kundër-

shtimi merr pamjen e hapur të protestës, të njëfarë revolte. Kuptohet, këto dukuri shfaqen në ngjyresa të theksuara individuale.

Djali ulet në tryezë për të ngrënë. Por nuk han siç duhet. E pyet: Nuk të pëlqen gjella? Qëllon që mund të thotë se nuk i pëlqen. Por mund të mos thotë asgjë. Madje mund të çohet edhe pa ngrënë, ose gjysme pa ngrënë, po i kërkove shkakun ballazi, mund edhe të mos e marrë vesh.

Po tek vajzat adoleshente çfarë shohim? Sigurisht, nuk gjejmë të njëjtën shkallë

që fëmija tashmë «nuk është më fëmijë». Që tani ai po bëhet «i zoti i vetit». Një kthesë tepër e rëndësishme jetësore, siç do ta shohim, jo pa kundërshtime e vështirësi në rritje. Mirëpo të dashur prindër sa jeni ju të përgatitur që të përballeni me këto të papritura që po ndodhin në mesin tuaj dhe të adoleshentit? A jeni në gjendje që t'i kuptoni, madje edhe ti pranoni me qetësi. Apo mos vallë shpesh ju acaroheni nga këto shenja të para të «burrërimit» të adoleshentit. Ju jeni mësuar që fëmija juaj të jetë i afrueshëm, i çiltër. Për ju këto cilësi u duket se po zhduken dhe ndjeni dhimbje për to. Ju menjëherë filloni të alarmuar që të veproni. Ju në këto raste shpesh filloni që të ia vini në dukje dhe tu thoni se «nuk jeni si më parë»? I pyesni se «çfarë po ndodhë me ju?». Por kur nuk e dini ju që jeni prindërit si mund ta dinë ata? Ky veprim i juaji sjell trazim edhe më tepër tek ata. Në këtë kohë ata duke qene se diçka nuk shkon, mundohen që ta fshihin duke u munduar që të bëjnë kthesë por kjo ndodhë pak orë ose pak ditë, varet nga intelekti i fëmijës. Në disa raste kjo sjell acarimin e mëtejshëm të gjendjes.

Kjo është më e vështira për të gjithë por në veçanti për ju të dashur prindër. Ju duhet që të jeni mjaft të kujdesshëm në këto raste ju duhet që të luteni shumë që Ati t'ua shndrit mendjen dhe tu falë durimin që ju me maturi të dini që ti pranoni dhe të dini që të udhëhiqni fëmijën tuaj në këtë udhëkryq të madh të jetës së tij. Jeta na ka mësuar mjaft ngjarje të tmerrshme që si pasojë kanë atë çka adoleshenca sjell me vete dhe paaftësia e prindërve për ti bërë ballë kësaj gjendjeje mund të sjellë që fëmija juaj të jetë dhe viktima juaj, prandaj ju kërkohet që të lutni Zotin që t'ua shndrit mendjen dhe të drejtojë hapat tuaj dhe të fëmijës për nga e mira. Pa ndihmën e Tij ju keni për të qene të vetëm dhe të paaftë që ti dalloni dhe të mbronni fëmijët dhe veten në këto raste.

(Vijon ne numrin e ardhshëm)

Roza Pjetri

Dëshmi shkrimi shqip, në Regjistrin e Kishës së Shalës, në Dioqezën e Pultit (shekullin XVIII)*

Mark Palnikaj

Objekt i studimit tonë janë do regjistrime pagëzimesh në gjuhën shqipe në një Regjistër Pagëzimesh, Martesash dhe Mortesh për zonën administrative që mbarështonte e ashtuquajtura Kishë e Shalës në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Përderisa regjistrin si të tillë e ende të panjohur në historinë ekleziastike të Arealit të Veriut katolik Shqiptar në shek. XVIII i jemi përkushtuar në një studim të mëvetësishëm, në këtë punim modest do të përqendrohemi vetëm në këto dëshmi shkrimi shqip që ndodhen në fol. 24v dhe 25r të regjistrin e që kumtojnë pagëzimin e tetë të porsalindurve në një hapësirë kohore prej rrokull katër muajsh (30 nëntor 1778 – 1 prill 1779)

Përpara se t'i përcjellim lexuesit këto dëshmi do të mjaftohemi fillimisht vetëm me kumtin hyrës sa u përket rrethanave ende të pasqaruara, se si dhe përse në këtë regjistër të vëllimshëm me plot 213 folje janë vetëm këto tetë regjistrime të shkruara shqip. Procedimi ndryshe në gjuhën e regjistrimit, ku feks vetem italishtja dhe rrallë latinishtja, ka të bëjë pas gjase me rrethanën se në periudhën në fjalë në Kishën e Shalës për një arësye a një tjetër kishte ndërprerë shërbimet ndaj grigjës katolike misionari i kësaj kishë Frat Michele Angelo da Acuta, duke u zëvendësuar përkohësisht prej Frat Onofrio da Bernarda me origjinë prej krahinës së Basilicata-s në Itali, i cili shërbente prej kohësh në Kishën e Kirit. Sa i përket arsyes që e ka shtyrë Frat Onofrion të kryente regjistrimet në gjuhën shqipe, hë për hë lejohemi të përsiasim si zgjidhje alternative procedurën e regjistrimeve në gjuhën shqipe që kryente rregullisht ky frat në famullinë ku shërbente rregullisht.

Parë nga kjo perspektivë, Regjistri i Kishës së Shalës nuk do parë asesi si një dukuri krejt e pazakonshme në Arqipeshkëvitë e atëhershme të Tivarit, të Durrësit e të Shkupit, pasi të gjitha famullitë asokohe ishin të detyruara me vendimet përkatëse të Kuvendit të Arbërit (Mërqinjë 1703) që të regjistronin me rreptësi në regjistrat përkatës të paktën dhurimin e sakramenteve të Pagëzimit, të Martesës dhe të Vojimit të Shenjtë para vdekjes. Aq më shumë fiton rëndësi në këtë rast zbulimi i këtij regjistri ende të panjohur në historinë e kishës dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi.

Le të njihemi tash me (A) riprodhimin diplomatik dhe (B) përshtatjen e tekstit me kodin e sotëm alfabetik dhe gjuhën e autorit, ashtu siç përcjellin këto regjistrime shqip, si vijon:

(A) *Lopsc, Die 30 9bris 1778*

Une F. Onof.º Pagheova Palin Pjetren, te bin t'Pjetr' Pepes', e Len Boghes. Me Cunor.

(B) *Lopsc, die 30 novembris 1778 (Lopç, ditën 30 nëntor 1778)*

Une Frat Onofrio, pagezova Palin Pjetren, te bijen e Pjeter Pepes dhe Lenes nga Boga. Me kunor.

(A) *Ab.º, Die 10 januarij 1778*

Pagheova Vat Prellin, te birin t'Prell Pepes', e Len' Boghes. Me Cunor.

(B) *Abati, Die 10 januarij 1778 (Abati [M.P.], ditën e 10 janarit 1779 [sic – M.P.]*

Pagezova Vat Prelen, te birin e Prel Pepes dhe Lenes nga Boga. Me kunor.

(A) *Lotaj; eadem Die 1778*

Pagheova Dill' Gieken' te bin t'Giek' Mucess, e Prend' Nikess: Me Cunor.

(B) *Lotaj; eadem Die 1778 (Lotaj; në të njëjtën ditë 1779 [sic – M.P.]*

Pagezova Dil Gjeken te bijen e Gjek Muçes dhe Prendes nga Nikajt. Me kunor.

(A) *Mesciaj 10 Marzo 1779*

Pagheova Dill' Gieken te bin t'Giek' Uikess', e Tringh' Nichess': Me Cunor

(B) *Meshaj 10 Marzo 1779 (Me[k]shaj 10 mars 1779)*

Pagezova Dil Gjeken te bijen e Gjek Ujkes dhe Tringes nga Nikajt. Me kunor.

(A) *Nizaj 1 Ap.lis 1779*

Pagheova Giok' Palin', te birin t'Pall' Vates, e Mach' Sumess': Me Cunor

(B) *Nicaj, 1 Aprilis 1779 (Nicaj 1 prill 1779)*

Pagezova Gjak Palin, te birin e Pal Vates dhe Makes nga Suma. Me kunor.

(A) *Christ' 1 Marzo 1779*

Pagheova Mihill', te birin t'Lezzit, e Len Salsess. Me Cunor.

(B) *Krist' 1 Marzo 1779 (Kristë, 1 mars 1779)*

Pagezova Mehillin, te birin e Lecit dhe te Lenes nga Salca. Me kunor.

(A) *Eadem Die*

Pagheova Stacc' Prell', te birin t'Prell' Mizzanit, e Len' Scrielles' – i pa Cunor.

(B) *Eadem Die (Të njëjtën ditë)*

Pagezova Stak Prellën, te birin e Prel Micanit dhe Lenës nga Shkreli – pa kunor.

Ghimaj, 30 Marzo 1779

Pagheova Zog Gielen, t'bijin t'Marasc Gielit e Giecc Nichess. Me Cunor.

(B) *Gimaj, 30 Marzo 1779 (Gimaj me 30 mars 1779)*

Pagezova Zoge Gjelen, te bijen e Gjelit dhe të Gjikes nga Nikajt. Me kunor

(A) *Dacaj 1. Ap.lis 1779 (Dakaj me 1 prill 1779)*

Pagheova Lech' Stachen' t'birin t'Staches, e Diell Sumess. Me Cunor.

(A) *Dakaj 1. Ap[ri]lis 1779 (Dakaj me 1 prill 1779)*


Pagezova Lek Staken, te birin e Stakes dhe te Dielles nga Suma. Me kunor.

Nuk është e vështirë që të vihet re që shkruesi gjuhën shqipe nuk e kishte gjuhë

dyskronjësh <ʒ>.

Për të shkruar tingullin /l/ në trup të fjalës, ai ka përdorur shkronjën dyfishe <ll>, ashtu siç përdoret në gjuhën italiane, duke mos bërë dallim midis /l/ e /ll/ të shqipes.

Si përfundim mund të shtojmë gjithashtu se trashëgimisë së kulturës së shkrimit shqip në shekullin XVIII i shtohen materiale të reja gjuhësore, që dëshmojnë se gjuha shqipe krahas italishtes përdorej



Facsimile e fol. 24v-25r e Regjistrin të Kishës së Shalës: @ M. Palnikaj

amtare andaj kemi mënjeluar vetëdijë në përshtatjen e tekstit (B) edhe zanoren /ë/ të patheksuar, e cila pas gjase ishte e pranishme atëkohë në dialektin e Dukagjinit, por që mungonte në ndërgegjen gjuhësore të autorit që nuk ishte shqipfolës i lindur.

Datat e pagëzimit të fëmijëve i ka shkruar në gjuhën e tij ose në gjuhën latine por jo në gjuhën shqipe. Kur i duhet të shkruajë tingullin /z/, ai përdor shkronjën <ε> duke ndjek traditën e shkrimit të shqipes në shekullin XVII nga autorët e vjetër, Budi, Bardhi e Bogdani.

Për të shkruar tingullin /c/, për shembull në fjalën Nicaj, ai ka përdorur çiftin

* Për zgjidhjen të problemeve që u shfaqën gjatë riprodhimit diplomatik dhe përshtatjes në kodin e sotëm alfabetik të materiali gjuhësor autori pati ndihmën e pakursyer të Prof. Dr. Anila Omarit. I përcjellim me këtë rast falenderimet tona të përzemërta duke theksuar gjithashtu që për çdo paqartësi e zgjidhje të diskutueshme është autori që mbart çdo përgjegjësi.

Marre nga revista "Hylli i Drites", nr. 2, viti 2020

DY HERË DIGJET SHOSHIT DHE SELIA E TIJ KISHTARE ME 1732 DHE 7 shkurt 1761

(Mbetet për tu konfirmuar edhe një e tretë)



Prelë Milani

“Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit” është njeri nga dhjetë kapitujt e librit “Kontribute për historinë Kishtare të Shqipërisë së Epërme të shekullit XVII-XIX të historianit arbëresh Italo Sarro. Studimi i tij është një përmbledhje koncize e Relacioneve në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan. Libri meriton një analize analitike në kontekstin historik të një periudhe dy shekullorë dramatike, gjakësore me grabitje shtazore por edhe të qëndresë drakoniane për ruajtjen lirisë dhe besimit nga agresioni frontal konvertues me shpatë dhe uratë. Autori flet pak e sak me gjuhën e dokumenteve burimore, të cilat duhet pranuar se janë të disi të thata skematike. më tepër të karakterit fetare se sa të natyrave historike apo fushave të tjera të diturisë.

Kapitulli Misionarët Françeskan në dioqezën e Pultit dhe djegia e Shoshit nuk është pa i njohur në rrethe shumë të ngushta studiuesish. Në mënyrë tangenciale si ngjarje e kam trajtuar edhe te Monografia “Shoshi”, por për mungesë të dhënash nuk jam futur brenda guaskës së kësaj ngjarje. Lajmet mbi këtë ngjarje të bujshme të kohës rezultojnë se janë përcjellë Republikës Venedik nga Zv/ konsulli i Venedikut në Shkodër Anton Duoda. Djegia Shoshit dhe qelës së tij kishtare është krye ngjarja më sublime, në historinë e qëndresë kundra islamizuesë në Dioqezën martire të Pultit.

ÇFARË NA REFEN SARRO

Në vitin 1760 Stambolli kishte caktua çmimin e detyrës të Pashës që ishte 25 mijë ZEKINA për zonën e Dukagjinit. Kjo betejë për këtë post u fitua nga prej Karamanit (Në popull dhe tek ndonjë burim tjetër thirret (Karamuçolli) Karaman Pasha. Ky mizor i korruptuar (nëvizimi im) gjeti dikë që ja dha borxh paratë e postit për me i derdhe në Arkën e Stambollit (Perandori sa madhe e luftarake po aq korruptuar po nëvizimi im) Pasha për nxjerrë paratë e veta filloj plaçkitjet më dhunë ndaj pronës së malësorëve por edhe me rrëzimin e objekteve të kultit të moçëm arbërorë Autori shkruan. “Pasha në krye të një ushtrie 10 mijë osmanësh dhe renegatësh filloi operacionin e haraçit për çdo shtëpi ”Grabitja e banesave u bë nga që malësorët kishin vonua shlyerjen

haraçit ose nuk ishin bindë. Shpesh këta administratorë të “paqësorë” organizonin ndjekje që përfundonin me kapjen e atyre që kishin ikë vetëm për të mos pagua haraçin. Në tilla raste fatkeqet i dërgonin në Pejë në Sarajet e Pashës ku kalbshin në burg deri kur familja të derdhte shumë e kerkueme..... Katundet, të cilave Karamani u kishte çua fjalë të parëve u shkelën me ushtri. Nikajt u detyruan të paguanin 1400 REAL, Shala 1300, Pani 800, Xhani 500, Palçi 400, Toplana 300. Populli i Shoshit dhe i Kirit tue kenë të varfër nuk pranuan, por nuk pritën me u zanë rob e me i çua në vargoj në Pejë por ikën te Pasha së Shkodrës duke kërkuar ndihmën e tij Pasha i Shkodrës sado që u tregua i hapur sa që i priti në qytetin e tij, prape se prape nuk mund ndalonte dorën e tjetrit (Begollajve). Karamani (Karamuçolli) mbasi mbloodhi një ushtri të madhe hyri në dioqezën e Pultit i vendosur me ba Shoshin dhe Kirin shkruamë hi. Për gjatë rrugës shumë pultjanë që nuk kishin mbërri me ikë i mori peng. Pasi shkretoi Kirin dhe zgjeroj radhët e veta e mësyni Shoshi me 7 të frorit 1761. Sulmi që vërtetë mizorë duke djegur gjithçka, kishën, hospicin e fretërve të vegjël kup-tohet dhe krejt katundin. Flakët e zjarreve dhe krejt lugina e masakrueme nuk mjaftuan me ja shua zemërimin pashës i cili u lëshua edhe kundër françeskanëve. Këta u dorëzuan vullnetarisht si pengje, që dhuna të merrte fund. Por prape se par, u rrahën, u morën zhag nëpër rrugët e katundit lakuriq, kambë zbathtë mbi borë dhe në fund i dënuan me vdekje. Vendim që ndoshta për shkaqe të rendit publik duhej të ekzekutohej jo aty por në Shalë. Këtu robërit i çuan te Velati Peci (Them se duhej shkruar Vlad Peci), i cili ndërhyri dhe i shpëtoi nga që ishte mik i Karamuçollit...Një vend të veçantë në këtë kapitull zë edhe mbajtja peng e një xhakoi 9 vjeçare të quajtur Gjergj Jak Tuci që pas një maratone te gjate vajtjesh dhe guximi të pa shoq, u lirua pasi prindërit dhe afërmit paguan 300 real.

ÇFARËNUK THOTË ATORI

Autori as një herë nuk gjykohet për çfarë nuk thotë. Ai edhe me kaq ka nxjerrë në cuhal mes diellit një xhevahir historik. Sarro natyrisht i qëndron besnik relacioneve që ka gjetur në arkiv. Në relacioni nuk thotë se si quhej kisha Shoshit që u dogj, por ajo dihej vetvetiu ka qenë Kisha Shendreit në fshatin Gurë si kryeqendër e Arqipeshkëvisë së Pultit. Autori duke qenë arbëresh i vjetër nuk ka qenë kurrë në Dukagjin por ndoshta as në Shqipëri dhe veç dokumentin nuk kishte ndonjë njohuri për këtë ngjarje. Dokumenti gjithmonë është një piketë, e burimit pastaj se nga rrjedhe e ku derdhet është çështje tjetër. Dokumenti për një studiues thotë shumë çka por jo gjithçka. At Zef Arapi në përmbledhjen e tij “Dukagjini në dokumente historike” nënvizon se: Beglerët

e Pejës e patën djegë Shoshin tre herë, pse nuk ndijoi me u nda prej Shkodre. Qindresë të madhe pat ba Shoshi në Forcë të Palajve e në Komlem të Shoshit. Qëndresa zgjati aq shumë sa kanë le 36 djem brenda kalasë.(kala natyrore nëvizimi im) Këtu gjenden edhe sot rrënojat”(Zef Arapi Dukagjini në dokumente historike. AMHSH fq.21 i dorëshkrim i daktilogra-fuar)

DJEGIA E PARE E SHOSHIT 1732

Studiues i mirënjohur Dr. Mark Palnikaj prej ashtës së Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan ka nxjerrë në dritë një dokument tjetër me rëndësi që përket viti 1732, që flet për digjen e kishës banesave dhe prerjes se pemëve të Shoshit Dokumenti që na ka zbuluar Palnikaj me 26 janar 2012 na rezultojnë tridhjetë vite më hershëm se ai që ka botuar Italo Sarro, por që indirekt nga konfirmon se Shoshi dhe qela e saj është djegur më shumë se dy herë, pse jo tre ashtu siç citon At Zef Arapi. pa përcaktuar tre kohërat e shkuara. Dokumenti është një letër e Prefektit të Misionit Françeskan të Pultit 1769. Sipas ti është fjala për një ekspeditë ndëshkues kundër banorëve të Shoshit të mirënjohur me shumë si kusarë se sa si besimtare të cilët nuk pranuan të paguanin taksen e Xhezasë Këtij fakti i referohen edhe studiuesit Peter Bartel dhe Bardhyl Demiraj në studimin e tyre me titull: “LETRA E FRETERVE TË PULTIT 1761 DHE VENDI I SAJ NË KULTURËN E SHKRIMIT SHQIP NËMESIN E SHEKULLIT 18-të

Në të dyja rastet Arratisja e shoshianve ka qenë bilike masive drejt shpellave të Karmës së Palajve dhe Komlemit Ka qenë dimër i tmerrshëm borën e kanë çarë me rrathë dhe ky ka qenë shkaku që i kanë shpëtuar asgjësimi të plot. Demet kanë qenë katastrofale Shoshi me 1764 tre vite pas djegies së dytë rezultojnë se ka pas 140 shpi me 1200 frymë. Nuk kam mbete gjie guri në këmbë pa shembë me gjyle dhe djegë me zjarr, drithi, gjeja e gjallë u asgjësuan në pjsën dërmuese. Banorëve të mjerë po thuaj të zhveshur si njerëzit prehistorik shpellat dhe mali ju bënë strehë, ndërkohë që askush nuk e din sa vdiqën nga plumbi zjarri apo bora e të ftohtit

Për analogji vetëm demi në banesa pa frikë e kaluar pragun e një numërori tre shifrorë. Me 1972 për herë të parë kam dëgjuar 100 vjeçarit Zef Gjeloşi i nga Lotajt e Shalës i cili duke falë më gjyshin tim tregoi historinë e Karamuçollit. Zefi kishte një mënyrë të treguarit dhe të interpretuarit sa ngjarjen ta sillte përpara syve sikur po luhej në real teatrin qëndresës e qëndresës së moçme. Nga At Arapi dhe kujtesa popullore ka mbetur e skalitur në shkëmb se gjatë rrethimi është varë Ndre Buxha nga Ndreajt. Operacioni ka vijuar ethshëm për disa kohë. Në synim të realizimit final u ndërtua Ura e Pejës në fshatin Pepsuj nga kanë kaluar mush-

kat me mortaja dhe poshtë fshatit Mollë nga Nënplepi është quajtur breshërisht Komlemin me topa të kalibrit malorë. Vendi ku flakëronin gjylet thirret që atëherë edhe deri më sot Curri i Topit. Aventurën e çmendur shfarosëse Haxhi Begu e pagoi me kokë prandaj vendi ku u sosi quhet shkëmbi i Haxhi Begut. 260 vjet kanë kaluar dhe kjo ngjarje që as një herë nuk harrua në kujtesën popullore por mbijetoj e veshur me aureolën e një misticizmi legjendar. 260 vite në terrin e herezisë dhe pa përgjegjshmërisë as një herë nuk u vlerësua as nuk u ngrit në panteonin që meriton. Kjo ngjarje është një epike qëndresë e martirizimi që matet me malet. Kjo ngjarje është elegji për gjakun e derdhur dhe sakrificat mbi njerëzore të shqipeve të Lekes, është lapidarë historie në altarin e kryqit të pa thyer. Larg çdo sentiment kjo ngjarje është dekoratë e klasit të parë për Shoshin primarë në gjitha ngjarje kapitale të historisë së Dukagjinit Kjo ngjarje nuk mund të anashkalohet as të belbëzohet për nën hundë. si deri më sot. Ajo duhet të zënë vendin që i takon në kalendarin e liturgjisë historike të Dukagjinit dhe me gjerë. Djegia e Shoshit dhe Selisë Kishtare në shkurt 1761 po ashtu edhe Kirit duhet vlerësuar jo për mendshitje krahinore por si mirënjohje për një emblemë të vjetër që i bën nderë historisë së Shqipërisë në radhe të pare pastaj dhe Kishës katolike shqiptare. Nëse ka nderim për vlerat të parëve dhe besimit të tyre të ngulitur në shkëmb, duhet ndërtoi një objekt memorial, ku çdo vit të behet një pelegrinazh përkujtimore dhe ta pasqyroj në këngë, poezi dhe art. Kjo periudhë duhet studiuar më themel, analizuar edhe pasuruar në dritën e fakteve të reja duke precizuar edhe një ose dy rastet e ngjashme si kjo që tashmë e ndriçuar nga dielli i historisë. Së pari po them Shoshi por nuk lëçis askënd tjetër. Duke ditë se nuk kemi as pushtet Lokal as qendrorë që merre vesh as do të ja dijë se pari kjo gjë i përket me shumë se kujt do rinisë mërgimtare. Ndërsa ne forcat intelektuale jemi gati kurdoherë ashtu si deri me sot, por makina pa karburant nuk lëvizë. Tashmë për këtë periudhë sa errtë por edhe të ndritur studiuesi Mark Palnikaj ka një mbushë “zhabë” me dokumente të Arkivit të Vatikanit që i ka mbledhur me zharkun e tij pasionant me sakrificat kosto financiare kohore, e udhëtimesh e. Ato dokumente duhen botuar, njohur, vlerësuar si nga visaret më vlerat të Dukagjinit të epërm. Mjaft më me këngë qesharakë për heroi të rremë që denigrojnë të vërtetat ndërkohë që te vërteta identitare mbetën sirtarëve të ndrymë me dy. Shkolla dioqezane e Kirit dhe Djegia e Shoshit Selisë Kishtare me 1732, 1761 dhe një akoma e pa zbardhur janë ngjarje më të rëndësishme në historinë e shekujve 17-19 -te.

Si u mbijetoi stuhive Kulla Mesjetare e Lekë Mark Gjekës së Traboinit



**Profesor
Gjon Frani Ivezaj**

Sa herë na bie rasti të dëgjojmë apo të flasim për kullat e hershme në Malësi të Madhe e para gjë që na vjen në mendje është një shtëpi guri me mure të larta e dritore të vogla. Tipike për vetëmbrojtje, e shumë të ngrohta për banorët e saj. Me oxhakë të naltë të shtresëzuar me nuanca të mugëta si nata, prej tymit të zjarrit të vatrës të pa shuar ndër shekuj, të cilët ngjajnë me rrathët e një lanë (trungu peme) që dëshmon për vjetërsinë e saj. Të vendosura shumë rrallë nëpër kodrat dhe malet e Malësisë, sa shpesh nga ulje ngritjet e terrenit duken si të vetmet në atë shpat mali, hija e së cilës i pret dhe përcjell rrezet e diellit si toka ditën dhe natën, të cilat, vijnë e shkojnë si bashkudhëtarë të përhershme në mot mote, e duke i dhanë kuptim gjithë rrjedhës së jetës së këtyre kullave. E tillë ishte edhe Kulla Mesjetare e Rrasës së Traboinit e trashëguar nga të bijtë e fisit të Nicajve, e cila veç lashtësisë së saj prej shumë brezash në gati pesë shekuj mbart brenda vetes histori ngjarjesh të mëdha sa vetë malet e Malësisë së Madhe.

Po ku gjendet dhe si mbijetoi kjo Kullë?

Kulla e Rranxës së Rrasës gjendet në Jug-Perëndim të Çemerrit në Traboin të Hotit, nën majën e Bukoviqit dhe fare pranë Kronit të Traboinit, prej së cilës me shtimin e popullsisë në këtë Lug është ngritur fshati Rranxa e Rrasës ose siç quhet ndryshe Traboini i Moçëm.

Sipas dokumenteve kadastral, kjo Kullë është zaptuar dhe rindërtuar në vitin 1571, në kohën e sundimit ushtarak, latino-venecian apo siç njihet botërisht, sundimit venedikas, i cili asokohe garnizonet dhe qendrat administrative i kishte vendosur në qytetin e Shkodrës, në Malësi, në Ulqin, në Tivar, e kudo në trevat e veriut. Thuhet se fillimisht kjo Kullë u rindërtua dhe përshtat për nevojat e një bazë ushtarake për të strehuar garnizonet me ushtar, dokumentet dhe armatimet që dispononin, të cilën e shfrytëzuan deri në momentet e fundit të sundimit të tyre. Edhe pas rënies së sundimit Venecian kjo kullë pati të njëjtin fat nga pushtuesit e huaj, duke ruajtur vijimisht statusin e një qendre ushtarake me mbikëqyrje të rrepte si pikë kontrolli mbi malësoret e Hotit dhe krahinave përreth. E gjitha kjo për faktin se gjendej fare pranë një burimi ujor çka plotësonte nevojat jetike të ushtarëve dhe nëpunësve. Dhe arsyeja tjetër ende më madhore, pse u zaptua kjo banesë ishte se, Kulla e Nicajve, ishte e ndërtuar mbi një pike strategjike të mbrojtur nga terreni çka i jepte përparësi të qenit e sigurte në rast sulmi nga vendasit, pasi të huajt ishin

të vetëdijshëm se, për malësorin nuk ka ma ulje se me i marrë pronën dhe nderin.

Sipas burimeve historike, të cilat flasin mbi të dhënat e kësaj Kulle, si dhe gojëdhënat e shumta ndër malësoret e Traboinit e zonave përreth, të memorizuara ndër breza, të ruajtura e trashëguar deri tek ne, thuhet se të parët e fisit të njohur Nicaj, edhe pse u pushtuan, u plaçkiten e u dogjën nga ushtritë e huaja, banorët e saj asnjëherë nuk njohën nënshtrimin ndaj pushtuesve, që nga ai Venecian e deri tek më të fundit, që ishin turqit. Kurrë nuk u tërhoqën nga përpjekjet e tyre për ta rimarrë atë kullë. Shpesh bashkoheshin të gjithë si vllazni ta sulmonin e ta digjnin vetëm që nderi i familjes të çohet në vend. Ndër këto sulme thuhet se kanë pasur edhe shumë humbje nga rrallët e djelmnisë së fisit, që më pas janë përball edhe me hakmarrje nga më çnjerëzoret, duke u djegur banesat, dëbuar e bastisur shtëpitë, por sërish janë kthyer e bashkuar për ta çuar deri në fund amanetin e t 'parëve të tyre. Të mbrojturit me jetë, të asaj që ishte më e shtrenjtë për ta: Trojet e t 'parëve të tyre dhe vatrën e zanafillës ku kishin të ngulura thellë rrënjët e tyre ilire.

Mbi heroizmin e treguar nga të parët e kësaj kulle, kanë shkruar edhe shumë autorë vendas dhe të huaj, ndër ta edhe studiuesja angleze, Miss Edith Durhan, e cila, në librin e saj "Brenga e Ballkanit", shkruan gjerësisht për këtë Kullë dhe malësorët trima te saj, veçanërisht për trimat e kullave tipike alpine shqiptare në Malësi.

Kulla e Nicajve është rimarrë me luftë te ashpër në vitin 1911, në të cilën kanë marrë pjesë shumë hotjanë trima.

Sikurse mësohet nga burimet historike, në luftën e ashpër të zhvilluar midis ushtrisë turke të armatosur gjerë në dhëmb dhe malësorëve që kishin një motiv më shumë për të luftuar duke mbrojtur shtëpitë e tyre dhe tërë Malësinë, gjatë këtyre përballjeve, armikut vazhdimisht i mbeten në fushën e betejës shumë të vrarë, municione dhe armatime luftarake.

Në kohën, kur Kulla e Rranxës së Rrasës ra në duart e luftëtarëve të lirisë, armatimet e shumta, iu shpërndanë luftëtarëve shqiptarë malësorë. Kjo ngjarje e madhe historike, ka hyrë në histori si lufta heroike për rimarrjen e Kullës së Nicajve, e cila u zhvillu më 14 mars të vitit 1911, në kohën kur luftëtarët e drejtuar nga trimi i pamposhtur Ded Gjon Luli, fituan betejën e tyre për marrjen e Kështjellës së Deçiçit, më 14 prill të vitit 1911. Nga frika dhe rezistenca e garnizonit turk thuhej se oborri i Kullës së Nicajve ishte shtrua kalldrëm nga gëzhogjat e plumbave të lëshuar në drejtim të hotjanëve traboinas. Në këtë përballje, u dallua heroizmi i trimit të maleve Lek Mark Gjekës, pinjoll i fisit Nicaj. Ai me një shkathtësi të pashoq kërcëu si luan mbi mesin e ushtarëve turq me armë duke vrarë e plagosur shumë prej tyre. Për marrjen e kësaj kulle luftuan heroikisht e gjithë djelmnia e Traboinit të Hotit, si

Zef e Gjek Meti, kushërinj të afërm me Leken, si dhe shumë hotjanë të tjerë, që iu bashkuan trimave në vendet e vetëmbrojtëse. Mbase mbaroi lufta me sukses dhe fitoren e banorëve të Traboinit të Hotit, trofetë dhe armët iu shpërndanë banorëve për çdo shtëpi, ndërsa robërit e luftës i lanë të lirë të shkojnë në atdheun e tyre, duke ia falur edhe jetën, mbase e kuptonin se ata ishin vegla të verbër në duart e komandanteve mizorë turq.

Kjo fisnikëri, zemërgjerësi, tregon edhe një herë, se malësorët tanë, asnjëherë, nuk kanë qenë vrasës, por kanë bërë gjithçka, duke dhënë edhe jetën, për mbrojtjen e trojeve të tyre të lënë trashëgim nga të parët brez mbas brezi.

Të bijtë e Kullës së Nicajve ishin të dalluar në tërë krahinën e Hotit për nga urtia, bujaria, trimëria dhe zgjuarsia. Të dashur e mikpritës për mikun, e të ashpër me luftua deri në pikën e fundit të gjakut me armikun dhe pushtuesin, që u zaptoi vatrën e tyre, ndaj e quaj nder dhe krenari ti rikujtojmë këta fatosa të lirisë, që asokohe me pushkë në dorë iu kundërvunë armikut më mizor, që për pese shekuj



Kulla Lekë Mark Gjekës



Gjon Pjeter Leka

kishte pushtuar trojet etnike shqiptare. Turqit historikisht nga malësorët tanë trima, kanë marrë një mësim e pësim të madh, duke dështuar në të gjitha përpjekjet e tyre, për të nënshtruar të panënshtuarit, që ishin dhe mbetën malësorët tanë trima dhe heroik. Pas rimarrjes së kësaj banese nga të bijtë e saj, Kulla e Nicajve u bë qendër e rëndësishme dhe strehe e sigurte, në të cilën mblidheshin të gjithë krerët dhe personalitetet e njohur të kom-

bit dhe maleve të Malësisë, duke i dhënë kështu një faqe të re e të lavdishme historie kësaj Kulle dhe bijve të saj, aq sa, edhe sot nëpër odat e pritjes ndër malësor, lakohet emri i atdhetarit të flaktë, malësorit kreshnik **Pjetër Leka**, si një burrë kohe, me virtyte të larta malësori, cilësi këto që ua mbrujti edhe të pesë fëmijëve të tij, Nikollës, Gjonit, Markut, Lekës dhe Gjystes.

Nikollën dhe Gjonin, dy të mëdhenjtë e kësaj vllaznie, kam pasur fatin ti njoh nga afër pasi ishin miq të familjes dhe fort të nderuar të rrethit tonë miqësor. Afrimiteti i madh që kam pasur me Gjonin, më nxiti ta risjell në vëmendje këtë histori dhe qëndresë heroike të fisit të tyre.

Gjon Pjeter Leka u lind me 28 gusht 1928 në Traboin të Hotit dhe vdiq me 1 tetor 2020 në New York ku edhe u varros, e prehet i qetë përkrah bashkëshortes se tij Palinës, duke lënë pas një veprimtari dhe kontributi të shquar prej malësori dhe patrioti shqiptar në mërgim.

Rrugët e vështira të mërgimit, Gjon Pjetri i ka marrë bashkë me familjen, gruan dhe pesë fëmijët e tij, që në maj të

vitit 1967. Fillimisht drejt Italisë e më pas në New York. Gjatë gjithë jetës së tij ka punuar me mish e me shpirt për ti rritur dhe mirë edukuar fëmijët me djersë e me nder, duke ruajtur të shenjta virtytet tradicionale të trashëguara e të mishëruara në Kullën fisnike të Nicajve, atje në Traboin të Hotit, të cilat i ka kultivuar e trashëguar edhe tek fëmijët e tij edhe këtu në mërgim.

Gjatë gjithë jetës së tij, Gjon Pjeter Leka u shqua si një aktivist dhe intelektual i mirënjohur, i cili iu bashkua qarqeve më të ndritura të bashkësisë shqiptaro – amerikane, duke marrë pjesë në tubime dhe demonstrata. Ai ka dhënë edhe një kontribut tejet të madh humanitar për nevojat e bashkësisë mbar shqiptare, që nga Amerika e deri në Malësi të Madhe.

Kulla e Nicajve mbetet një shembull tipik i qëndresës dhe burmisë në Malësi. Kësaj Kulle, e cila për nga vlera dhe lashtësia meriton të cilësohet Monument Kulture, ti këndohet kënga me lahute e i t'i tregohet lavdia ndër kuvendet e Maleve të Malësisë e më gjere!

Masakra e Manastirit

Në fillim të viteve 20-të të shekullit XIX, u duk se Perandoria Osmane nuk mund të kishte asses forcën, që pat demonstruar për shekuj me radhe. Ndonëse Sulltan Selimi III ndërmoi një varg masash për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë, ai nuk mund të shmangte dot ardhjen gjithnjë e më të furishme të një lëvizjeje çlirimtare, që inspirohej prej popujve të sunduar. Ndonëse reformat e nisura me aq bujë, mbeten në mes të rrugës, ato u përpoqti vijojë më pas Sulltan Mahmuti II.

Me të hipur në front, Sulltan Mahmuti i II u përpoq të dobësonte sa më shumë të ishte e mundur pushtetin krahinor të feudaleve në krejt Perandorinë Osmane. Një varg dekretesh dhe reformash të zbatuara me masa të rrepta ndëshkuese, sidoqoftë ndonëse i dhanë një shkëlqim të rreme karrierës së tij, nuk mund të shpëtonin dot rënien e Perandorisë. Tashme, në horizont ishin shfaqur të tjerë sulltanë, që quheshin Care dhe kërkonin të “bënin zapt” jo vetëm Azinë, por edhe Evropën.

Në pranverën e vitit 1827, kur flota ruse korri fitore të bujshme ndaj asaj turko-egjiptiane, u duk se lufta ruse-turke nuk do të vononte shumë. E zhvilluar në vitin 1828-1829, kjo luftë përfundoi përgjithësisht me fitoren e Ruisë, e cila me këtë rast legjitimoi disa pushtime, që pat bere në brigjet e Detit të Zi si edhe disa vende të pjesës evropiane. Ndërkaq, Porta e Larte duhej të zbatonte edhe kushtet e përcaktuara në Paqen e Bukureshtit dhe që lidheshin me marrjen nën kontroll të Carit të Ruisë, Serbia, Moldavia dhe Vllahia.

Kur Porta e Larte parashihte t'i shkëputeshin edhe troje të tjera sundimit të saj, ajo ngulmoi të nisë dhunën dhe represionin nder nacionaliteteve të shtypur. Sulltan Mahmuti II, në këtë kohe shpërndau regjimentet e mëdha të jeniçerëve, me të cilët dikur pat sunduar me thundër të hekurit, dhe organizoi ushtrinë e rregullt. Ai gjithashtu u përpoq t'u kufizonte pushtetin e tyre ekonomik të pashallarëve dhe kapedaneve, të cilët në këto masa parandienin centralizimin autokrat të Sulltanit. Veçanërisht pashallarët shqiptare, nuk mund të duronin këto reforma centralizuese ndaj edhe kundërshtuan të luftojnë me ushtrinë e tyre kundër ofensivës ruse. E vërteta është se, vrasja e Ali Pashe Tepelenës, u shoqërua me disa masa të Portës së Larte, për t'u kufizuar shqiptareve

të drejtat, sidomos në rrafsh të organizimit të administratës vendase. Në këtë mënyre, krerët shqiptare patën nisur të bashkërendojnë veprimet, duke kërkuar liri më të madhe si ne qeverisjen vendore, ashtu edhe në organizimet e tjera të karakterit ushtarak. Këtij qëllimi i shërbyen edhe tri kuvende madhore, të mbajtur prej prijësve shqiptare, në Berat, Janinë dhe Gjirokastrë. Ndofta më i përparuar, në kuptimin e kërkesave ka qene kuvendi i Beratit, i mbajtur në nëntorin e vitit 1828, me pjesëmarrjen e krerëve të Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Jugut. Pos të tjerave, kapedanet shqiptare në këtë kuvend, i dërguan Sulltan



Mahmutit II një kërkesë për dëbimin e Mehmet Reshit Pashës, nga posti i qeveritarit të sanxhaqeve të Janinës, Delvinës dhe Vlorës. Gjithashtu, në kërkesë thuhej edhe për “largimin e të gjithë nëpunësve turq, që kishin ardhur gjate periudhës 1822-1828”. (“Kryengritjet popullore kundër osmanë në Shqipëri”-Tirane, 1981, faqe 41).

Në pranverën e vitit 1829, kur patën nisur të dalin në drite marrëveshjet e Paqes së Bukureshtit midis Ruisë dhe Turqisë, mjaft prej krerëve shqiptare pësuan zhgënjim lidhur me pashallëqet e tyre. Nder ta, Mustaf Bushati, i cili asaj kohe ishte komandant i një ushtrie të madhe shqiptare në brigjet e Danubit, nuk u konfrontua fare me ruset, por u nis drejt Stambollit. Duke pasur edhe përkrahjen e disa pashallarëve të tjerë, ai iu drejtua Stambollit, me qëllim që kushtet e vendosura në Bukuresht midis Portës së Larte dhe Ruisë të përcaktonin edhe autonominë e trojeve të Bushatlinjeve. E vërteta, është se Porta e Larte, në fillim iu tremb marshimit të Mustafa Pashës drejt Stambollit. Ndonëse ai pat shkuar

deri në brigjet e Danubit të luftonte kundër ruseve, me dinakërinë karakteristike, ai e shmangu ushtrinë e vet disa mijëshe prej luftimeve. Por kësaj radhe, në ndihme të Stambollit shkuan vete trupat ruse. Në vendin e quajtur Arnaut Kalesi, në tetorin e vitit 1828, ruset rrethuan ushtrinë shqiptare duke i bere thirrje për dorëzim. Por Mustafa Bushati urdhëroi sulmin dhe pas tre dite luftimesh të ashpra, u detyrua të tërhiqej nga vendimi i marre. Në krye të ushtrisë së tij, e cila pësoi humbje të konsiderueshme, Mustafa Pasha u detyrua të shkonte në viset e veta. Në vitin 1830, Greqia shpalli Pavarësinë e saj. Mbas dhjete vjet luftimesh

shqiptare, ku munden të gjejnë dobësi, Porta e Larte pagoi para, ose afroi karriqe në pushtetin e vet. Ndërsa për të tjerët, nuk mungoi deri edhe t'i vrase. Kështu, në fund të vitit 1829, Porta e Larte vrau Ismail Bej Vlorën (babanë e Qemal bej Vlorës) ngase ky i pat deklaruar Stambollit, që pashallëkun e tij “nuk do të shohë asnjë këmbë nëpunësi osman”.

Pas vrasjes së Ismail Bej Vlorës, si edhe dy-tri prijësve të tjerë në Janinë dhe Gjirokastrë, Porta e Larte mendoi se, diçka do të ndryshonte në revoltën e shqiptareve. Por masat e gjera popullore shqiptarë, të zhytura në varfëri e mjerim, të rrethuar prej errësirës së sundimit, nuk mund të frikoheshin prej shkaqeve të tilla të terrorit fizik. Në fillim të vitit 1830, në disa prej Vilajeteve shqiptare, protestat kundër taksave si edhe ligjeve të rekrutimit

për ushtarë, u fuqizuan dhe nuk munguan t'i drejtoheshin me tone të ashpra Stambollit. Pikërisht në këtë kohe, ai i preu kokën në Berat, Hasan Bej Vronit dhe e vari më pas dhe në Manastir, Shaban Gegen. Është kjo arsyeja, që në verën e vitit 1830, u përgatit dhe u zhvillua masakra e Manastirit, e cila për nga lloji i vet, është krejt e veçante jo vetëm në Ballkan, por edhe në Botë. Kështu, që për të vendosur sundimin e hekurt në Shqipëri, Porta e Larte, dërgoi në korrik të vitit 1830, një ushtri të madhe atje,

të komanduar prej Mehmet Reshit Pashës. Ky ushtarak njihej jo shumë për trimërinë, se sa për ligësinë dhe pabesi. Me të mbërritur në Manastir, në fund të muajit korrik 1830, Mehmet Reshit Pasha, hapi fjalë, se kishte marre urdhër prej Sulltan Mahmutit II, që të bisedonte me shqiptaret, në mënyre që të gjente gjuhen e përbashkët me ta. Ai nuk mungoi gjithashtu të fliste, se sipas Sulltanit, disa kapedane shqiptare, që patën luftuar kundër Greqisë “do të marrin paratë sipas kushteve të caktuara më pare”. (Instituti i historisë-Tiranë, fondi i dokumenteve të Vjenës, letër e Bericht, date 30 korrik 1830).

Në ditët e para të gushtit 1830, në krejt viset shqiptare, u shpërndanë lajmëtare të Mehmet Reshit Pashës, të cilët u dorëzuan prijësve shqiptare ftesat e firmosura prej vete Sadrazemit me ç ‘rast thirreshin në Manastir. Sipas teksteve të këtyre fermanëve, prijëset shqiptare thirreshin në Manastir, për të marre pjesë në ceremoninë ushtarake, për shkak të riorganizimit të Ushtrisë, si edhe për të lexuar disa dekret-falje të Sulltan Mahmutit II,

DEL NË DRITË EKZISTENCA E SHKOLLËS DIOQEZANE TË KIRIT 1760-1773

(Një fakt i dobishëm që bën nderë historisë së Dukagjinit)

Kontribute për historinë Kishtare të Shqipërisë së Epërme të shekullit XVII-XIX, quhet libri Historianit arbëresh Italo Sarro "Duke u mbështetur në Relacionet dokumentare të Arkivit e Propogandes Fide në Vatikan, ky autor na ka dhuruar një fakt të dobishëm historik të pa njohur".

Shkolla diqeziane e Shkodres fillimisht u vendos në territorin e Spas, ndërsa rreth vitit 1760 u shpërngul në Kir, në dioqezën e Pultit. Ky vendim, sipas Imzot Gjergj Junikit, nuk ishte urti, pse ishte vështirë me gjet shtëpi të përshtatshme për këtë përdorim edhe pse i sillte pasoja



ndaj disa prijësve shqiptare si edhe t'u jepeshin rrogat atyre shqiptareve, që patën luftuar kundër Greqisë. E vërteta është se shumë prijës e kapedane shqiptare, menduan se gjithçka ishte normale. Ndërsa greket festonin Pavarësinë, fqinjët e tjerë do të kishin mundësi së paku për t'iu shmangur atyre taksave të renda apo detyrimeve ushtarake tejet të ashpra. Të rritur mes maleve, të edukuar me nder e besë nga gjenerata në gjenerate dhe për më tej, kur shumica e shqiptareve të asaj kohe e pat rregulluar jetën sipas ligjeve të kanunit, këta prijës shqiptare nuk do të mund të arrinin deri tek djallëzia e skajshme e Mehmet Reshit Pashës, me origjinë nga Gjeorgjia. Ndërkaq, ky i fundit, pat caktuar datën e sakte, të dielën e fundit të muajit gusht, në të cilën do të zhvillohej parada e madhe ushtarake, për nderin e të ftuarve.

Kësisoj, për të ardhur me 26 gusht 1830, ditën e asaj gjemë të madhe, burimet osmane flasin për më shumë se 500 prijës shqiptare, të cilët patën zënë vend në tribunën e ngritur në qendër të qytetit të Manastirit. Ndërsa çadra e zbukuruar e Mehmet Reshit Pashës, ka qene e vendosur diku më larg tribunës, në një vend më të larte, kinse për të ndjekur më mirë këtë parade. "Por ndërsa parakalonin përpara miqve (të ftuarve), ushtaret turq përnjëherësh, sipas udhëzimeve u ndalen nga tribuna dhe filluan të qëllonin në befasi mbi feudalet dhe prijëset shqiptare. Brenda pak minutave u shfarosen kështu me tradhti, më shumë se 500 shqiptare". (Historia e Shqipërisë-Tiranë, vëllimi I, 1959, faqe 483).

Janë serish burimet arkivore Turke, që thonë se, pas vrasjes barbare, prijësit shqiptare iu nënshtruan një tjetër barbarizëm. Mehmet Reshit Pasha, urdhëroi që kokat e prijësve të priten dhe të dërgohen menjëherë në Stamboll, me ç' rast Sulltan Mahmuti II i ka afuar shpërblime të majme Sa-

drazemit të tij. Gjaku, që skuqi rrugët e sheshet e Manastirit vijoi deri në Stamboll, kudo i binte ere tradhtie. Kjo masakër e Portës së Larte, nuk mund të kalonte pa u ndier në krejt vilajetet shqiptare e më tej. Ajo ishte e para në llojin e vet dhe për të arritur qëllimet e veta, Porta e larte nuk mungonte të organizonte edhe tragjedi të tilla. Ndofta do të ishte me vend, sillja këtu një kënge shqiptare, që flet për këtë masakër të dhimbshme ndaj trimave shqiptare.

Asllan beu me Veli benë
Në Meçovë bëne benë,
Në Manastir do të venë,
Të kërkojnë Ylefenë.

Po s'ua dha me të mirë,
Do të djegim Manastirin
Veziri beri gostinë,
Thirri Asllan dhe Velinë,

Tek e thirri mbe të pare
Se Veziri të ka si djalë,
Veli beut i erdhi rende
Tha: O Asllan mos u trembë.

Kur ra batareja e parë
Asllan beu lonte rehvanë
Kur ra batareja e dytë,
Asllan beu po hapte sytë,
Kur ra batareja e tretë,
Asllan beu beri përpjete.

Ike, ike, o çil i shkrete,
Se qorr pasha na vjen vete,
As e shihni Qorr pashanë,
Se si ka përveshur krahne
Marre gargine mbe njanë
Për Velini e për Asllanë

(Thimi Mitko "Bleta Shqiptare",
Vjenë 1924, faqe 80)

Dy prej personazheve të kësaj kënge, Asllan Kuçi dhe Veli Gorashjani, kane qene kapedane të njohur

shqiptare, të cilët shkuan të luftojnë kundër Greqisë (ajo u mbështet gjerësisht prej Francës dhe Anglisë).

Këta dy kapedane luftuan për muaj të tere kundër ushtareve greke, duke rrefyer heroizma të mëdha. Ndërkaq, duke pare se lufta e popullit grek, ishte në thelb luftë për Pavarësinë e një nacionaliteti, këta prijës shqiptare si edhe plote të tjerë, u tërhoqën nga fusha e betejës duke ndjere intuitivisht, se në këto rrethana mund të ndodheshin edhe ata vete, të nesërmen. Sidoqoftë masakra e Manastirit nuk mund të përmblihet në një hakmarrje të verbër ndaj dy kapedaneve shqiptare, emrat e të cilëve i përmend kënga e mësipërme.

"Kurthi I përgatitur, ishte në vete politiken e Sulltanit gjakësor, i cili nuk kishte marre parasysh, se ata nuk mund të bënin më shumë në Greqi. Por, është edhe për të ardhur keq, se si qe e mundur, të paktën për një pjese të parisë shqiptare, që të mos të kuptonte se, përderisa sulltan Mahmuti II, katër vjet më pare, kishte shpartaluar korpusin e Jeniçerëve, pse të mos ndodhte e njëjta gjë me ta?! Besimi i verbër beri që shqiptaret të bien në kurth" (Profesor Koli Xoxe, "Franca sipas D' Istres"-Tiranë, 1992, faqe 251).

Por masakra e Manastirit e 26 gushtit 1830 do të ishte edhe një dimension tjetër, po aq rrëqethës, por tanimë në një tjetër treve shqiptare, në Janinë. Edhe këtu, në të njëjtën dite është organizuar tragjedia sipas të njëjtit skenar, prej Emin Pashës, të birit të Mehmet Reshit Pashës.

Ky pati thirrur aty dhjetëra prej kapedaneve më të dëgjuar nga Jugu i Shqipërisë, midis të cilëve edhe Çelo Picari, Zylyftar Poda, Zenel Gjoleka e të tjerë. E vërteta është, se këta prijës shqiptare, nuk u besuan këtyre ceremonive ushtarake ndaj edhe refuzuan pjesëmarrjen. Ndërkaq, ish konsulli

banorëve.... Eksperimenti në dioqezën e Pultit nuk duhet ta ketë pas jetën e lehtë, e cila 1773 u shpërngul në Shëldi.

Hapja e kësaj shkollë në Kirë është bërë për arsye sigurie në kushte një represioni fatal ndaj besimit të krishterë në Ultësirën shkodorane

Agron Luka

"Mësonjëtorja e Korçës" ishte legale me leje nga qeveria e Sulltani... , kurse këto shkolla në male, vijojnë një traditë të perpjekjeve ilegale në vijimesi për rrujtjen e shkrimit në gjuhën vendase.

Ju uroj ju Prel, e sidomos Mark Palnikaj, që atë lloj shkrimi, që ka vijue Shkodra qytetare ka 5-6 shekuj e ka pasë edhe elita kulturore e maleve katolike: "shkrimin sipas mënyrës tregtare = me gjuhën albanishte/arbanishte epirotishte me germa lettere latine".

Prele Milani

franceze në Janinë, Ezhen Pushade, në librin e vet "Turq dhe krishtere", duke përshkruar masakrën e Janinës, flet vetëm për disa kapedane të vrarë prej dorës së Emin Pashës. Babe e bir, kishin ndjekur të njëjtën rrugë krimi, duke marre kështu jetën e pafajshme të qindra prijësve shqiptare.

Pas masakrës në Janinë dhe Manastir ku u vranë dhe u theren rreth 500 prijës shqiptare, Mehmet Reshit Pasha dhe i biri, Emin Pasha, vijuan djegiet, vrasjet dhe plaçkitjet në mase kundrejt popullsisë shqiptare të pambrojtur. Mbi bazën e një plani fort bukur të studiuar, babë e bir, iu drejtuan me ushtrinë e tyre dhjetëra mijëshe, sidomos fortesave dhe kështjellave natyrore të shqiptareve, duke djegur ato, me ç' rast donin të shuanin me çdo kusht qëndresën e "arnauteve të pabindur".

Në këtë varg luftimesh të papara, Porta e Larte kërkonte të vraste edhe të fundmit prijës shqiptare, që patën mbetur gjalle dhe për më tej, të qeveriste jo vetëm me pashallarë, por edhe nëpunës të vegjël turq.

Anipse vilajetet shqiptare u shndërruan në fushë-beteja të mëdha, ani pse në vitet 1830-1831, çetat e prijësve shqiptare pësuan humbje të konsiderueshme, përsëri revolta e shqiptareve nuk u shua. Një varg kryengritjesh të viteve 1833-1835, të cilët përfshinë Dibrën, Kosovën e të tjera dëshmuar se dredhitë, masakrat, luftërat me armë nuk do t'i ndalnin dot shqiptaret në rrugën e tyre të mevesimit. Shpirti kryeneç dhe i pavarur shqiptar, dëshira e tij për Liri dhe Vetëqeverisje, kishin dale fitimtare mbi logjikën e luftërave për të ardhmen e tyre nacionale.

Nga Eugen Shehu,
me 1 shtator 2016
Paraqitë për botim,
Ndue Mici

LULASH NDOC GILA, KËNAQËSI QË TË KISHIM, DHIMBJE QË NA IKE!

Nga një goditje e rëndë dhe e pakthyeshme e tensionit, më 25.2.2021, u nda nga kjo jetë Lulash Ndoc Gila, një burrë i nderuar, një mik e dashamirë me të gjithë ata që takoj e punoj, njeriu gojëmbël, tradicional dhe bashkëkohor, një zoteni i vërtetë në trevezë e tavolinë, në rugë e zyrë, në karrige e në sallë, familje e shoqëri, në drejtim dhe zbatim.

Lulash Ndoci u lind në një truall të hershëm, të përmendur për mirë në breza, në Gecaj të fshatit Lotajve të krahinës së Shalës. Ishte filiz, natyrisht jo aspak i vetëm dhe u bë mriz në trojet e gjyshit Gjon Ndoci dhe Bejto Ndocit, burra të përmendur për luftë e punë, për shtëpi e shoqëri, për trevezë e mikpritje, në kuvende e kushtrime, në Kodër të Gecajve, u rrit me mësimet e vyera të brezave të parëve, të prindërve e axhëve të tij, të burrave të fshatit Lotajve e të krahinës së Shalës, përfitoj dije e kulturë të plotë popullore tradicionale dhe e pasuroj gjatë jetës me kulturën bashkëkohore.

Lulashi është djali i Ndoc Gjonit dhe Leze Marashes, kjo, bijë në shtëpinë e përmendur për mirë të Marash Sokolit të Mekshajve të fshatit Nënnavriqi të krahinës së Shalës.

Është arsimuar për mësuesi, e kjo e përgatiti jo vetëm në drejtim të edukimit të brezit të ri, por edhe për jetën shoqërore të fshatit, të zonës, të krahinës dhe më

gjërë.

Kolektivizimi i bujqësisë e gjene në detyrën e mësuesit, por nevoja e kohës, kultura dhe përgatitja e tij, dhe pa tjetër tabani familjar i tij, e thirri që të drejton-te në ekonominë e përbashkët që u ngrit



në Lotaj. Ai bashkë me shokët e tij, me urtësinë, qetësinë, tolerancën e bashkëpunimin e ndërsjellët me bashkëfshatarët e tij pati rezultate për kohën kur drejtoj.

Reformimi e riorganizimi, dhe me kërkesën e tij, rikthehet në detyrën e arsimtarit duke punuar në disa fshatra të Dukagjinit, dhe kudo flasin vetëm mirë për të.

Por përsëri koha e thirri në drejtimin e Këshillit të Bashkuar të krahinës së Pult, që u zgjodh për disa vite, pastaj si kryetar i degës së kuadrin në krahinën e Shalës,

deri më ndërrimin e sistemit politik. Vitet e fundit të punës para daljes në pension i kaloi përsëri në arsim.

Lulashi krijoi familjen duke u martuar me Marien, bija e Kolë Delisë nga fshati Gimaj, burrë e familje me zë në Gimaj, Shalë e Dukagjin. Ata ngritën një familje shumë të mirë për tua pas lakmi. Maria ishte mbështetje e plotë dhe e fuqishme në gjithë punën dhe jetën e Lulashit, në familje e shoqëri, me besnikërinë e saj, me kulturën e mirësjelljes së saj, me mikpritjen e saj, e gjithmonë e gatshme vetëm për të ndihmuar shokun e saj të jetës, që sot vdekja i ndau.

Kjo periudhë e vështirë pandemie dhe dimri jo të lehtë, është pengesë e madhe për përcjelljen në banesën e fundit të këtij burri të nderuar dhe të shumë e shumë të tjerëve më parë.

Ai po ngjitet në amshim, për tu bashkuar me prindërit, gjyshat, vëllezërit, axhët e engjellin e vogël, djalin e tij, i ndarë nga jeta në moshë fëmijërore e shumë shokë e miq, midis të cilëve edhe bashkëfshatarët e tij, shokët, kumbarët e dashamirët, Marash Kola e Ndoc Grimaj, të ndarë nga jeta kohët e fundit.

Lulash, ty të kishim shumë mik e shok, e jo vetëm unë, por dhjetëra e qindra, sepse dije vetëm të bëje miq e shokë, por dhe të ruaje miqësinë dhe shoqërinë. Ti po ndahesh nga ne, nga kjo jetë dhe ndar-

ja kurdoherë është mjaftë e mërzitshme, por po len familjen tënde shembullore, bashkëshorten Marie, djalin, vajzat, që u kujdesën shumë për ty, dhe plot nipa e mbesa, veçanërisht djemtë e axhës Martin që të qëndruan pranë në çdo moment, po len një shoqëri shumë të mirë dhe të pastër që lotojnë për ty, të cilët janë e duhet të jenë krenar për gjithë punën dhe jetën tënde.

U largove nga kjo jetë me ballin lart e fytyrën e pastër. Jemi krenar që të kishim dhe ndjejmë dhimbje që u largove nga kjo jetë. Do të donim që të kishim edhe shumë kohë midis nesh, por i gjithëfuqishmi kështu mendoj.

Miku im Lulash, bashkë me Zef Lulash Sokolin, e latë një amanet, një mesazh, një testament, për brezin e sotëm dhe ata që vinë, nëpërmes faqeve të librit “Lotajt e Shalës” që ju studiuat dhe botuat, që është një kujtesë shumë e vlefshme jo vetëm për Lotajt kudo janë, por për të gjithë ata që mund ta marrin në dorë.

Bashkëshortja ime, Gjystja, kushërira dhe dashamirësja jote me plot respekt, dhe unë ndjejmë shumë dhimbje për ndarjen tënde nga jeta, Lulash, por këtë na e shton edhe ma shumë pamundësia për të përcjellë për në banesën e fundit.

Pushofsh në paqe, e lehtë dhe e bekuar të qoftë toka që të mban o Lulash Ndoci! Lamtumirë!

Luigj Shyti

VDESE NJERIU, POR JO EMERI

Këto ditë u nda nga jeta në SHBA, në moshë 88 vjeçare Ndue Mark Martini (Vuksanaj). Lindi në fshatin Theth të krahinës së Shalës, në një familje me tradita të shkëlqyera për besë, patriotizëm e atdhedashuri. Ashtu si në të gjithë Shqipërinë, edhe kësaj familje me ardhjen e komunizmit, nuk ju ndanë vuajtjet, torturat e persekutimet, të pa kufi. Sa edhe në Zot nuk kishin më besim!! Madje disa here thoshin “o Zot pse na u bane hasem?!” Mark Martini, babai i Ndojës, me tre vëllezërit e tij pushkatohe pa gjyq, madje dhe pa u lidhur sytë. Pal Martini pushkatohet në Guci. Leka e Lulashi në fshatin Valbonë. Ndërsa Mark Martini arrestohet në Markatomaj të Lezhës dhe pushkatohet në Han të Hotit. Dëshmitaret okular kanë treguar se, pasi e kanë qëlluar me breshëri automatiku, gjatë ka qëndruar në këmbë. Rushe Ndocja fatkeqe, mbeti në Theth me 4 fëmijë jetimë. Dy djem e dy vajza (Gjoka, Ndoja, Drandja e Mara). Rushja ishte nën një presion, psikologjik dhe dhune. Në këto kushte pasi konsultohet me axhën e vet, Lulash Malën, vendosi të arratiset bashkë me vajzën Marë. Arratisja ishte vendim për të kaluar në Mal të Zi, ose për të vdekur e vrarë nga forcat e kufirit. Pra, mos me rënë në duart e komunisteve e gjallë. Duke lënë në Theth tre fëmijë pa nënë pa babë. Jeta ishte bërë shumë e vështirë. Pas disa ditësh, internojnë Gjokën e Dranden në Tepelenë.

Ndoja mbeti te kushërinjtë e tij. Pasi mbarojë shkollën fillore në fshatin Theth, me nota të shkëlqyera, në moshën 13 vjeç arratiset për në Mal të Zi. Duke udhëtuar për 5 orë natën rrëzë malit të Jezercës, arrii në Guci. Qëllimi ishte të bashkohej me nënën e motrën. Falë zgjuarsisë, arriti të realizonte ëndrrën e tij. U bashkua gjysma e familjes. Fatmirësisht në Guci jetonin dajat e Ndojës, të cilët i përkrahen. Edhe këta të arratisur për t'i shpëtuar regjimit.



Djali i axhës të Rushes, Vuksan Grim Mala i strehojë dhe ju qëndrojë gjithmonë pranë. Ndoja e Mara u martuan dhe krijuan familje. U lidhen me një familje

shumë të respektuar Kelmendase, siç ishte shtëpia e Dedë Zef Nikçit. Drande Zefja, nusja e Ndojës jetuan shumë vite në Mal të Zi. Vazhduan shkollat. Ndërtuan shtëpi. Në vitin 1968 emigrojnë në SHBA, për një jetë më të mire. Dhe kështu ndodhi: Amerika u priu për mbarë. Ndoja pas pak vitesh, arriti të bëhet biznesmen i fuqishëm. Fëmijët u shkolluan në profesione të ndryshme. Asnjëherë nuk e harruan Thethin e Shqipërinë. Ndoja me Dranden linden e rriten 8 fëmijë me edukate e qytetërim Amerikanë. Sot nga ky çift janë dhjetëra e dhjetëra, djem, vajza, nipa e mbesa, të cilët i kanë bërë të njihen krenar prindërit e tyre. Për rreth 4 dekada nuk arriti të shkelte në Shqipëri. Ai mbajti lidhje me intelektualë dhe klerikë të shquar, që mundë të theksojmë: Ernest Koliqin, Martin Camajn, Rrok Mirditën, Danjel Gjeçajnë, Ambroz Martinaj, Sami Repishtin, Zef Oroshin e të tjerë. Për kontributet e meritat e tij, është vlerësuar me dhjetëra urdhra e medalje, çka do të thotë se ka vdekur si njeri, por emri i tij jeton!...

Ndoja asnjëherë nuk harroj Okolin e Thethit, aty ku lumi i Shalës e ka burimin. Aty ku Gega e ka floririn. Atje mbretër janë të tanë! Por mbret i mbretërve ka gene Ndue Mark Martini (Vuksanaj). Pas vendosjes së pluralizmit në Shqipëri, arriti të shkelë në token amë. Sa po zbriti nga avioni në Rinas i përplotur puthi token Shqiptare, që e solli në jetë. Emocione të fuqishme.

Shpirti human i tij ishte i pa parashikuar dhe i pastër qelbar. Ndihmojë me dhjetëra familje Shqiptare, që shkuan në Amerikë. Më shumë ndihmojë të afërmit

në Theth. Ishte mundësori kryesor i fondëve për rindërtimin e Kishës në Theth. Sot ajo qëndron si simbol i bukurive të asaj perle.

Ikja pa kthim në botën tjetër e këtij personaliteti të shquar, pikëlloje rëndë familjen, të afërmit, dhe shoqërinë e tij të nderuar. Përcjellja për në banesën e fundit ju bë në Njujork, me një pjesë marrje, jo vetëm nga shqiptarët, por edhe qindra Amerikanë. Ishin mbledhur për t' i dhënë lamtumirën e fundit, shumë miq e dashamirës.

Vdekja e tij u përkujtua edhe në qytetin e Shkodrës, që aq shumë e deshi. Për nder e respekt të këtij burri, nipat Mikeli, Gjovalini e Zefi dhe kushërinjtë Gjergj, Pjeter e Lazer Luka me familjet e tyre, organizuan një pritje në Bar-Restorant “Kol Pingu”, me datën 28.02.2021, ku morën pjesë dhjetëra e dhjetëra të afërmit e qytetar të Shkodrës e më gjere.

U shua në ditët e fundit të shkurtit, të një viti jo të brishtë. Ne i shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta, bashkëshortes Drande, djemve e vajzave, nipave e mbesave të gjithë të afërmeve, për humbjen e njeriut, të cilët i deshi dhe e deshën aq shumë.

U prehesh në paqe!

Të qoftë dhe i lehtë, i dashur kushëri! Mbetesh zambak bjeshke i bardhë, si vet shpirti yt!

Të deshëm mes nesh, në krye të trevezës, në dasma, pse jo edhe në hidhërime, sepse në raste të tilla ti jepte force, çka e mposhtje sadopak dhimbjen!

Përgatiti Ndue Ziçi

Disa këshilla të dobishme për të mbrojtur zemrën tuaj sipas mjekeve të specialiteteve të ndryshme në rang botëror. Në ditën botërore të sëmundjeve të zemrës dhe trurit

Sëmundjet e zemrës si kudo në bote dhe në vendin tone vrasin më tepër se të gjitha llojet e kancerit (sido që është, është sëmundje e pa shërueshme), po shtohen rastet e infarkteve në moshat e reja dhe tek grat e reja. Sido që me futjen e metodave të reja të fibrinolizes dhe angioplastikes me vendosje të stentit (unazave) vdekjet kane zbritur nga 30-40% vitet 95, para fibrinolizes në 10%, me perspektivë për të arritur në 1%.

Disa këshilla që japin specialistet e ndryshëm në bote për të mbrojtur zemrën tuaj:

1-Mund të merrni dhe vezë. Regjimi pa kolesterol nuk ul aq fort nivelin e tij në gjak, dhe ushqimet që përmbajnë shumë kolesterol kane shpesh veprim anioksidant, vezët janë shumë të pasura me proteina dhe yndyra esenciale, -*Carolyn D-Mjeke et natyropathe*

2-Fleni 8 ore gjumë në nate-. Mungesa e gjumit favorizon hipertencionin dhe pra rrit rrezikun për zemrën. Provoni të flini nga ora 22.00 të darkës, mos shikoni televizion para se të shtrihen për gjumë dhe siguron errësirë të plot në dhomën e gjumit. Mos pini kafe pas dite dhe as alkool ne darke. -*Jennifer Hyathe-cardiologe-Universiteti -Columbia -New York*

3-Mos përdorni ashensorin-ngjitni shkallet. Ashensori dhe modernizimet e tjera ulin sforcimin fizik të përditshëm, prandaj ecni në këmbë dhe ngjitni shkallet dhe harrojeni ashensorin. *Richard Wright-cardiolog -Californi*

4-Meditoni- Organizmi i stresuar prodhon katekolamina (hormone që japin një përgjigje të furishme) ose kriza, gjë që mund të provokojë lodhje, cedence ose kriza zemre. Prandaj meditimi për 20 minuta në dite mund tu ndihmojë. *Archona Saxena-Crdologe New-Jork*

5-Per të mbetur shumë aktiv-Merruni me sport, ecje me hap të shpejt ose vrapim që në rini dhe pas 70 vjeç mundohuni të qëndroni aktiv, shëtisni, punoni në kopsht, ecni, notoni e të tjera. Të gjitha ushtrimet fizike ju ndihmojnë që të përfitoni prej tyre. *Prof Christian Brohet, cardiolog në Belgjik*

6- E qeshura duhet të zërë një vend të rëndësishme në përditshmërinë tuaj ... Humori, hareja bën që të riaktivizohen problemet ditore. E qeshura zgjeron arteriet dhe ul hipertensionin. *Suzanne Steinboun Cardiologe, në New York*

7- Hani fruta të vogla. Keto fruta përmbajnë antioksidant natyral dhe vitamina E, në pigmentin që u japin ngjyrën, qofshin të freskëta apo të ngrira-janë të mira për zemrën si, boronica, karota, aroret e të tjera.

8.Percaktoni(matni)TA-në 2015 efshtë vërtetuar se rënia e TA-sistolik në nivel normal 120\80 mm\Hg. Pakson 25% nivelin e vdekjeve nga insuficiencia (pamjaf-tueshmëria) e zemrës, nga atakët (krizat) e zemrës dhe nga goditja në tru(stroka-pika)-AVC. Pra, duhet të bëjmë ushtrime dhe të ushqehemi shëndetshëm. *Sipas Cora E. Lewis -Universiteti Alabama.*

9.Duhet të përdorim prodhime qumështi

të fermentuara. Agrumet janë të pasura me flavanoide dhe vitamina C, është mirë të përdoret kos, yagourt i cili është burim i shkëlqyeshëm i Kalciumit, duket se ka lidhje midis shëndetit të zemrës e enëve të gjakut dhe probiotikeve, që janë të bollshme në produktet e fermentuara të qumështit. - *Prof. Jean Michel-Institut Pasteur Lille*

10.Duhet të vaksinoheni kundër gripit stinor çdo vit. Vaksina e gripit është jashtëzakonisht e rëndësishme të behet sidomos për personat që vuajnë nga zemra dhe se fundi është vërtetuar se mbron nga aritmitë e zemrës si-Fibrilacioni atrial. - *Jason Guechard-kardiolog Birmingham -Alabama*

11-Kujdesi për dhembet-Higjiena e mirë e gojës lehtëson përkohësisht inflamacionin e përgjithshëm (sistemik)-nuk dihet akoma se në ç' mënyrë pakëson krizat e zemrës dhe atakun cerebral (AVC); gjë që ka debate prej dekadash, por ajo që dihet vërtete, është se një gojë e shëndoshe përmirëson cilësinë e jetës. -*Juli Clary-cadiologe -Universiteti Indiana*

12-Mos merrni shume kripe gjelle (NaCl). Sido që debatohet prej kohesh për kripën e gjellës-si person them të mos përdoret kripore në tavolinën e ngrënies-shtoni erëza si rozmarine, majdanoz, mendër basilicacurcuma e të tjera dhe të kënaqeni, gjë që e bej dhe mos kaloni 5-6 gr kripe gjelle në dite. *Prof. Clair Mounier-Inst. Cardio-pulmonar Lilli, President i Federates Franceze të Cardiologjis*

13- Bëjeni rregull ecjen në këmbë (pra lëvizni). Unë e kam larg stacionin nga zyra mbi 1,5 km dhe eci gjithnjë në këmbë, dhe po të vini me makine parkojeni larg, që të ecni në këmbë ndonjë km. Po ashtu mos merrni ashensor vetëm ngjituni për shkalle dhe kur të flitni në telefon ngrihuni në këmbë, në mbledhje qëndroni në këmbë dhe bëni 30 minuta aktivitet fizik për të paktën 5 dite në jave pa llogaritur këto lëvizjet që behën. *Prof. Francois Carre-Cardiolog Rennes-Universiteti CHU*

14-Mos hezitoni të hani peshk-sardele-Hani 1-2 here në jave peshk të pasur me OMEGA-3 si sardele, ton, levrek i egër e të tjera, kjo është e nevojshme për shëndetin e zemrës dhe të enëve të gjakut. - *Prof. Jean Michel-Lille-France*

15-Duhet të ndiqet sheqeri në gjak (glycemia) - Sëmundjet e zemrës dhe atakët (goditjet) e trurit (AVC) janë shkaku më i shpeshte tek të sëmuret e rritur diabetikë. Shëndoshja, përdorimi i pijeve të ëmbla, të gazuara ose i çdo ëmbëlsirë mund të rrisin sheqerin në gjak (glicemine) dhe krijojnë insullino-rrezistence, duke bere që të mos veproje insulina. Pra, te dy janë faktor pararendës (paralajmërues) të diabetit. *Richard Wright*

16-Beni seanca intensive Aerobie. Ushtrimet aerobike janë të mira për zemrën, ulin TA (Tensionin e larte), pakësojnë trigliceridet e këqija dhe rrisin kolesterolin e mire (HDL-K). Pra, ushtrime dhe ecje çdo dite me rritem për 30-45 minuta 5 dite



në jave, duke mos e harruar asnjë dite ecje të shkurtra dhe lëvizje. *Paul. B. Longvin -anestezist Philadelphia -Pensilvani*

17-Kaloni kohen në ajër të paster - Ndërgjegjësojuni se shëtitja, shkuarja në teatër, në një ose shfaqje show -ose pamja e një filmi-e ulin ngarkesën e trurit dhe ul stres-in dhe po ashtu shëtitja në diell krijon rezerva të vitaminës D-*Menyo De -Internist në Los Angjelos -Kaliforni.*

18-Menaxhoni stres-in tuaj-Stresi është i njohur si një facto rreziku për zemrën-Sporti joga, pauzat e meditimit në pune, muzika, kafshët shtëpiake shoqëruet ose shënimet në bllok e të tjera. secili në mënyrën e vet heq tencionin dhe relaksohet. Po ashtu dëgjoni muzike. - *Dr. Raymond Kalenbogen-klinika e readaptimit Chu -Saint -Pierre-Brukselle*

19-Beni një angiografi-Një Tomodensitometri e zemrës lejon që të zbulohen vaujtjet e hareshme të një sëmundje të zemrës dhe sot ky është bere një ekzaminim i rutinës, për të zbuluar shenjat e para të sëmundjeve të zemrës dhe po ashtu me kosto jo aq të shtrenjte. - *Guicara*

20-Merrni vitaminën K-2 - Studimet më të fundit kane treguar se vitamina K-2 është kryesore për shëndetin e zemrës. Ajo transporton kalciumin në kocka dhe nuk lejon të vendoset në enët e gjakut dhe mund të pastroje murin e enëve të gjakut.- *Adam Splover*

21-Mos neglizhoni sexin-si gjithë ushtrimet e tjera kalitës funksionon dhe është i shkëlqyer për muskulin e zemrës për te dy sexet dhe shpesh është e favorshme duke ndihmuar zemrën. - *Richard Wright*

22-Mos u mashtroni nga ëmbëlsirat (sheqeri)-Në kuzhine duhet kujdes-duhet përdorur ushqim i ndryshëm, me pak brumëra me fruta; zarzavate (perime) të stinës të freskëta, por dhe të frigoriferit-eliminoni pjatat me shumë kripe me pastërma-ulni yndyrat shtazore-merrni vaj ulliri. Pra, vendosni barrierë për yndyrat e ngopura, sepse janë të dëmshme për zemrën dhe enët e gjakut, por mos harroni dhe sheqeri është i rrezikshëm për enët e gjakut. - *Prof. christian Brohet-Cardiolog në Belgjike (Louvain).*

23-Kufizoni alkoolin-Një përdorim i moderuar i alkoolit 1-2 masa (40 ml), ose 1-2 gota vere (250 ml) mund të ketë efekt pozitiv, duke kontribuar për prevenimin e sëmundjeve të zemrës (në verat e staxhionuara në ene druri dhe alkoolit e rrushit përmbajnë resveratrol dhe sasi të madhe nitro-oksidi NO, me efekt vazodilatator).

Por përdorimi i dozave të mëdha të alkoolit rrezikon për goditje në trustroks (AVC). - *Dr. Samuel Molley-Linja Angleze*

24-Sado që të jeni i zënë, bëni të paktën tre here në jave lëvizje qoftë në palestër apo në shtëpi për 45 minuta, gjë iu ndihmon për shëndetin. Llogaritni të ecni në këmbë, me biçikleta ose një aktivitet sportive. - *Dr. Francois Carre -Reinne.*

25-Pini shume ujë -Pini të paktën 6-8 gota (225 ml) ujë, që do të thotë 1.5 -2 l në 24 ore veç lëngjeve të tjera, që merrni me ushqime, gjë që diluon lëngjet e organizmit e redukton rrezikun për sëmundje të zemrës, sepse dehidratimi rrit hematokritin, d.m.th. volumin që zënë rruazat e kuqe. Pra, e bën gjakun me viskoz faktor që favorizon atakun e zemrës dhe goditjen në tru (AVC), stroka. - *Jasson Guichard*

26-Vlersoni gjumin-Bllokimi gjate gjumit frymëmarrjes e ashtuquajtura "apnea e gjumit", është një ndërprerje e marrjes fryme për disa sekonda, që privon organizmin nga oksigjeni (O2) si zemrën, trurin dhe indet e tjera, gjë që ka pasoja. - *Adam Splaver*

27-Vlersoni marrjen e vitaminës D. Ka një lidhje midis mungesës së vitaminës D dhe vdekjeve nga zemra (infarcti i myocardit) dhe goditjes në tru (AVC) dhe po ashtu mungesa e vitaminës D, është e

me HTA dhe hyperglicemine te dy faktor rreziku për zemrën. Pra, duhet të matet niveli i vitaminës D dhe duhet të merren shtesa të saj së bashku me kalcium në dozat e nevojshme. - *Nitin Kumar*

28-Dieta vegjetarianë-Vitet e fundit ekipet e kardiologëve kane vendosur një program të OMS (OBSh) readaptimin intensive për të sëmuret me zemër, me që ka pasur një rezultat të pa pare (spektakular) mjeket kane vendosur ta zbatojnë. Pra, aspekti qëndron në dietën vegjetarianë 3 mujore dhe provat janë të kënaqeshe, duke u ndjere më pak të fryrë dhe më aktiv pas ngrënies. - *Joseph A. Craf -kaddiolog. -M saint Luis*

29-Merrni Magnez -Mg. ndihmon për të mos u rritur kolesterolin-merrni pluhur Mg. Citrat në ujë ose dhe tableta me vitamina B6 gjate ditës. - *Carolin Dean*

30.Favorizoni mirënjohjen- Një studim ka vlerësuar se subjektet, që provojnë një mirënjohje të thelle dhe kane kënaqësi në jete janë më pak të prekur nga sëmundjet e zemrës. Pra, miqësia dhe qeneje i lumtur zgjat jetën dhe ule rrezikun për kriza zemre dhe goditje në tru.

31-Mos hani asgjë të bardhe-"miell të bardhe, as sheqer, as oriz të bardhe". - *Adam Splaver*

32-Hani çokollatë të zeze- Një studim i kryer në vitin 2016 tregoi se një sasi jo e madhe ditore e çokolatës së zeze parandalon diabetin e sheqerit (D. M). Po ashtu bën arteret më elastike dhe ul TA tensionin e larte)-përdorni 30-60 gr çokollate në dite.

Përktheu dhe e përshtati në Shqip-Dr. Med. Ndue Nikaj

Gëzim Ajgeraj: PIKËPAMJE PËR JETËN DHE PËRVOJAT



PRENDA SEJDIA

1- Ata që të ndihmuan në momente të vështira

2- Ata që të braktisën në momente të vështira

3- Ata që krijuan momente të vështira

Tek shfletojmë ndër krijimtarinë e shkrimtarit Gëzim Ajgeraj, është vërtetë një miniere e tejmbushur me gjithë llojet e pasurive minerare, argjend e flori në fushën letrare. Edhe në këtë libër sjell shembuj tejet të mrekullueshëm, interesantë e me vlera. Është vetë njeriu, karakteri i brendshëm, ndërtimi i tij shpirtërorë dhe ndërgjegjja, e cila është e ndër-tuar brenda tij. Pena e autorit sjell më shumë delikatesë dhe në mënyrë tejet filozofike këto thënie kaq me vlera në formën e porosisë apo dhe të kriterëve që njerëzit të ti kenë para sysh në udhëtimin e gjatë jetë.

Ne jemi qenie njerëzore, prandaj mendimi i përsosmërisë sikur më tremb, por inteligjenca thotë Ajgeraj, njeriun e bën të përsosur.

Në këtë proces le të jemi mirënjohës njerëzve që na bëjnë të lumtur, si kundër ndryshimi i mënyrës së sjelljes në raste të veçanta të braktisjes nga miku (mikja) janë momente të vështira mendoj unë, kështu që e mësove kur duhet të hipësh nëpër pemë e kur nuk duhet ta bësh këtë.

Shoqëria është një rregullator mbi bazën e së cilës, jeni ju që bëni zgjedhjen më të mirë thotë autori.

Është përvoja e shkrimtarit, poetit, kritikut, e të tjera.

Njeriut me përvoja të jashtëzakonshme jetësore në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe filozofike që shtjellon probleme të ndryshme nder njerëzore ku shpalosen tipat e karaktereve.

Reflektimi i autorit në libër është tepër i gjallë veçanërisht ndërmjet “Fjalive të veçanta”.

Ai del hapur se, është për ruajtjen e vlerave njerëzore, forcimin e karakterit dhe pro njeriut vital.

Pena e Gëzim Ajgeraj, në këtë libër me një stil kaq të veçantë e tejet interesant i ndarë në pika kryesore që i shërbejnë gjithë gjeneratave, bazuar mbi eksperiencat e tij por edhe nga tradita popullore, tregon virtytet e larta njerëzore, që i burojnë nga thellësi e shpirtit.

Është një thënie e rrallë: “Nuk ka rëndësi nëse i keni bërë keq dikujt, në qoftë se kemi mësuar të mos i bëni më. Nëse nuk bëni më keq. Nëse mësoni, nëse jeni të aftë të merrni jetën në duart tuaja dhe ta përqafoji, vetëm nga kjo pikë mund të vazhdoni. Vetëm kështu vjen progresi. E tillë është jeta”.

Ky libër mund të konceptohet si përrua i nën-dheshëm, që në rrjedhën e tij të padukshme merr ndjenjat e fshehura të njerëzisë, në çastin siç i ka nxjerrë ato në sipërfaqe.

Ajgeraj analizon qëndrimin e të tjerëve, i kupton ata dhe ndikon pozitivisht në mendimin e lexuesit.

Njëkohësisht ka dhuntinë dhe temperamentin e artistit ky shkrimtarë brilant e shumë dimensional .

“Kafka ka thënë: Faji është një qenie brenda së cilës ndodhemi të gjithë pavarësisht nga faji”.

Kështu edhe Ajgeraj e thotë në këtë libër kaq shumë dimensional, me pak fjalë e shumë domethënie se, nuk ka të pagabueshëm, ama të gabojmë sa më pak të jetë e mundur.

Autori sjell leksione mbi dhjetë pikat për jetën, jetëshkrime dhe këshilla tejet interesante, me stil tejet origjinal, madje hyjnore, që dalin në dritën e diellit si rrezet e arta në mëngjes, ku këtë shkrimtarë e renditë në përmasat e krijuesit të post modernizmit dhe len gjurmë të pashlyera në kujtesën

e gjithsecilit, gjithashtu lufton hapur smirën, ligësitë, mediokritetin, arrogancën që sot bota po i vuan.

Ajo çka e karakterizon autorin është zëri kritik mbi koherenten, ku flet për shthurjen, shfrenimet, intrigat a moskokëçarjet, ikjet a rikthimet, dhe përçon mesazhet plot dritë për jetën.

Në një garë që shpall Gjergj Kastrioti në festimet e Krujës, kërkohet kërcimtarja më e mirë duke synuar shpërblimin, por dhe duke dashur të tregojë vetveten, valltarët rreshtohen njëra pas tjetres.

Fillimisht Koliqi, për ta bërë garën më emocionuese, përshkruan kërcimin e Turkinës, e cila bën një vallëzim tepër pasional, ku dallohet temperamentin e gruas plot feminitet.

Në kohën kur të gjithë mendojnë se ajo do të fitojnë madje edhe lexuesi.

Koliqi bën një kthesë me tregimin e tij, siç ndodh zakonisht në gara e konkurse.

Nxjerr në skenë Lulen, mbesën e Lekë Dukagjinit. Përshkrimi i kërcimit të saj është nga perlat më të rralla të letërsisë shqiptare.

Koliqi duke përshkruar vallen, përshkruan shpirtin, karakterin e vendit vet. Kështu që duke pasur parasysh 10 pikat:

- Tre tipa njerëzish rreth teje,
- Meritat dhe grabitësit e tyre,
- Mos lejoni që njerëzit negativë të huazojnë hapësira në kohën tuaj. Rriteni çmimin e qerasë dhe ata largojnë vetveten,
- Edukimi yt nuk mbaron me përfundimin e shkollimit, por do vazhdojë gjatë gjithë jetës,
- Kurrë mos vuaj nga fakti se çka mendojnë të tjerët për suksesin tuaj,
- Sa më shumë që ti japësh dikujt, që nuk e meriton aq më shumë mosmirënjohës bëhesh,
- Kurrë mos e gjyko tjetrin për diçka që nuk e ke përjetuar ti,
- Kurrë mos e prit nga tjetri atë, që ju jeni të gatshëm ta bëni për të, sepse do të ndihemi të zhgënjyer,
- Jo gjithçka i nënshtrohet forcës, zgjedh atë më të mirën deri në qëllim,
- Familja mbi të gjitha.

Autori bëhet virtyt, vlerë, frymëzim, oazë ku botës i kthehet në ngazëllim si engjëjt e ajrit dhe çlirimit ku davaritin retë, dhe qiellin e hapësirës mes iluzi-

onsh pafund.

Kthehet në potencial, ku ndez dritën jeshile të shpresës dhe diturisë.

Nga ajo botë e brendshme me thesare të pafundme.

Mëson se si kandilat e shpresës të mbahen ndezur. Dhe dashuria më e madhe të respektosh lirinë e tjetrit.

Nga këndvështrimi im, nëpërmjet pikave të paracaktuara në librin “Pikëpamja për jetën dhe përvoja” guxon me mendimin kritik të hedhur në formë psiko-filozofike, autori sjell një gamë të gjere specifikash ku hallet, problemet, shqetësimet, mosmarrëveshjet, keqkuptimet, mos-vlerësimet, janë pjesë e mangët e dijes, kulturës apo vlerësimit real të asaj çka të rrethon (në rastin konkret kur ka fenomene të ngjashme).

Diskriminon rastet e errëta që ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndër-shoqërore apo synon të ti ndëshkojë ato elemente të papërshtatshëm të shoqërisë, që me veprime të papjekura dhe pamatura ka efekte domino.

Ky libër me vlera edukative dhe artistike motivet i paraqet me ndjenjë të shpirtit dhe shkëndijohet në hapësirat e art- bërjes. Nëse vërejmë mirë pikat e paracaktuara të art- bërjes sigurisht se do të ndjehet zërin, ndjenjën e shpirtit paraqet për një motiv apo temë të caktuar.

Magjia e ndjenjave që ka për artin dhe mjeshtëria deri në përsosmëri, bëhen pasqyra e refleksioneve të tij edhe për ndjenjën e akceptimit tek lexuesit.

Diversiteti i rrëfimit dhe magjia në art sjell qetësinë shpirtërore të mendjes njerëzore.

Këshillat vijnë si shkëndija, si dritë që hap shtigje ku njerëzia e ndjen dhe e prek atë.

Pikërisht brenda këtij fenomeni qëndron e magjishmja si ndjenjë individuale që e ndjen krijuesi, problemi i përgjithshëm përmes mesazheve, ai përcjell tek publiku i gjere, duke e ngritur si ndjenjë dhe duke e përcjellë atë ku, si çështje duhet përqaftuar edhe vetë lexuesi.

Autorin e përkufizoj me thënien e Neitzche: “Diell, po të mos ishin njerëzit që i ngroh e u jep jetë, ç ‘kuptim do të kishte lindja jote?!”

REDAKSIA

Kryeredaktore: LUIGJ SHYTI

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
KUJTIM FUNIÇI

